

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7627 E martë 21 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SULEJMAN MATO

Mos u bëfsh kurrë për spital"-më
Lka thënë dikur nëna ime. Atëherë
isha i ri dhe sigurisht nuk e kuptoja
në ishte ky një mallkim apo qortim për
punonjësit ...

Vijon në faqen 20

Mjekësi e lodhur, indiferente
ose "mos u bëfsh për spital"



Opinion

Ditës

Nga WES MARTIN

Edhe njëherë, Mostafa Moham-
madi, një agjent i Ministrisë së
Inteligjencës së Iranit (MOIS) vazh-
don të tregojë gënjeshtrenë e tij të dalë
boje. Këtë herë ...

Vijon në faqen 21

Terrorizmi dhe propaganda,
pjesë e një strategjie



Kushëriri vrau me thikë 27-vjeçarin

Drama në Shkodër, familja ngujohet: Besa ka mbaruar, jetojmë me frikë

Të afërmit e autorit të vrasjes u larguan
jashtë vendit, fisi vuan pasojat e krimit

Një vrasje me thikë e ndodhur në prill të këtij viti në fshatin
Hot i Ri në Shkodër shkatërroi jetën e dy familjeve; njëra
humbi djalin vetëm 27 vjeç, ndërsa familja e autorit ka frikë
nga gjakmarrja. Kristijan Shkambi në festën e Pashkëve
goditi për vdekje Kolë Fermosin, dhe ndërsa kanë kaluar
4 muaj në ngujim, djali i axhës i autorit, Anesti ...

Në faqen 8

PERPLASJA PER EDMOND BEGO, PD: TRAFIKANT I LIDHUR ME SOCIALISTET

I ARRESTUARI PER DROGE, DESHMIA NE GJYQIN GREK

Biznesmeni u dënua në Itali me 21 vjet burg, në Shqipëri bëri 2 vjet. Grekët e
lënë në qeli, në pritje të ekstradimit në Itali. Policia: Nuk kërkohej nga Interpoli



(Në foto) Biznesmeni Edmond Bega

Në faqen 3

INTERVISTA

Tabaku: Qeveria,
500 mln euro për
të bojatisur qendrat
bosh të qyteteve

Në faqet 4-5

MUZEU I TEPELENS

Kur shtrati ishte
dhomë, jeta që
niste nga kamioni
i deportimeve

Në faqen 12

FESTA E BEKTASHINJVE

300 mijë pelegrinë
nga Shqipëria dhe
diaspora në
malin e Tomorit

Në faqen 19

SUMMER PAGES

Adelina Tahiri,
fotografite e
festës para se
të bëhet nënë

Suplement

NGA FERDINAND SAMARXHI



Pelegrinazhi,
Kurbani dhe
Haxhinjtë e parë
shqiptarë në Mekë

Në faqet 10-11

Dokumentacioni i plotë për konkurrim, çfarë duhet të dorëzojnë jetimët dhe invalidët

Studimet master, zbardhen datat e aplikimeve

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët e interesuar

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë kandidatët që
dëshirojnë të vazhdojnë
studimet në një nga
programet e nivelit master
në institucionet e arsimit të
lartë publik në vend, kanë
mundësinë të aplikojnë
deri në 12 tetor të këtij viti.



"Gazeta Shqiptare" zbardh
sot vendimin e Këshillit
të Ministrave në të cilin
theksohet se këto aplikime
për master shkencor apo
profesional do të kryhen
pranë sekretarive mësi-
more të njësisë kryesore.
"Aplikimet në programet ...

Në faqen 9

DROGA NE SHQIPERI RAPORTI I CIA-S

“Evident pastrimi i parave që lidhet me trafikun e lëndëve narkotike”

Raporti i CIA-s: Shqipëria burim kryesor për prodhimin e kanabisit

"Pikë aktive për transitin e drogave nga Azia Jugperëndimore"

Ina Allkanjari

Shqipëria vazhdon të mbetet burim kryesor për prodhimin e kanabisit dhe një pikë aktive për transitin e drogave nga Azia Jugperëndimore drejt Europës. Ky është konkluzioni i nxjerrë nga CIA në raportin e publikuar, për vendet e rajonit ku ka evidentuar Shqipërinë sërish si një vend problematik. Në përditësimin e fundit në faqen zyrtare të CIA-s të bërë më 14 gusht, shihet edhe përshkrimi që i bëhet Shqipërisë në lidhje me drogat e paligjshme, ku vendi ynë shihet si vend burimi i kanabisit. Por kështu thuhet se ka organizata aktive shqiptare të narkotrafikut të shpërndara në Europë. "Shqipëria vazhdon të mbetet burim i rëndësishëm për prodhimin e kanabisit si dhe një pikë aktive për transitin e drogave nga Azia Jugperëndimore", thuhet në raport. Ndër të tjera në përshkrimin për Shqipërinë thuhet se është rrugë ballkanike për transitin e hashashit dhe kanabisit dhe pjesërisht kokainës nga Amerika e Jugut e destinuar për Europën Perëndimore. Burim kryesor për prodhimin e kanabisit. Organizatat aktive shqiptare të narkotrafikut të shpërndara në Europë. Vulnerabel për pastrimin e parave që lidhet me trafikimin rajonal të narkotikëve, armëve, kontrabandës dhe qenieve njerëzore. Pra, për sa i përket korrupsionit thuhet se është evident pastrimi i parave, që lidhet me trafikun e lëndëve narkotike dhe të qenieve njerëzore. Gjithashtu, Inteligjenca Amerikane jep alarmin për shtimin e rrezikut të terrorizmit në Mal të Zi. Në raport thuhet se sektori japonez "Aum Shinrikyo" po përmirë-



son rrjetin e tij në Malin e Zi, megjithëse shumica e anëtarëve u dëbuan dy vjet

më parë. Mali i Zi është i vetmi vend në rajon ku CIA paralajmëron për rrezikun e

terrorizmit. CIA thotë se Serbia nuk i zgjidhi problemet kufitare me Kosovën, Kroacinë dhe Bosnje dhe Hercegovinën. Pretendohet se rruga për transportimin e heroinës nga Azia në Evropë kalon nëpër Serbi dhe se ekonomia e saj është e ndjeshme kur është fjala për pastrimin e parave. Në Bosnje dhe Hercegovinë, thuhet se po trajtohet problemi i pastrimit të parave dhe korrupsionit, ndërsa gjyqësori është i dobët. Po ashtu thuhet se Kroacia është një vend transit për kontrabandën e kokainës nga Amerika e Jugut në Europën Perëndimore.

"Spekulim politik për të cenuar punën e Policisë së Shtetit"

Prezantimi i Shqipërisë nga CIA, reagon Ministria e Brendshme: I pasaktë, ja e vërteta

Përmes një deklarate, Ministria e Brendshme ka reaguar ditën e djeshme duke sqaruar se raporti i CIA-s mbi situatën e sigurisë në Shqipëri, është i pasaktë dhe keq-orientues për publikun. Sipas këtij institucioni nuk ka ndonjë raport specifik të kësaj organizate të publikuar në ditët e fundit në lidhje me situatën në Shqipëri. Ministria e Brendshme thekson se nuk ka asnjë raport të CIA-s gjatë këtyre ditëve të fundit, dhe këtë raport e konsideron "produkt të organizatës The World Factbook që përditësohet çdo javë". Sipas Ministrisë së Brendshme të dhënat në raportin e CIA për Shqipërinë dhe Ballkanin, janë të njëjta me atë të vitit 2017. "Ministria e Brendshme sqaron se lajmi i dalë në media në lidhje me publikimin e një raporti të ri të CIA-s mbi situatën e




sigurisë në Shqipëri, është i pasaktë dhe keq-orientues për publikun. Sqarojmë se nuk ka ndonjë raport specifik të kësaj organizate të publikuar në ditët e fundit në lidhje me situatën në Shqipëri. "The World Factbook", është i publikuar në faqen zyrtare të CIA-s. Ky është një produkt i kësaj organizate që përditësohet në mënyrë të përvajshme dhe përmbajtja është lehtësisht e aksesueshme online. Pra, megjithëse përditësimi i fundit është i datës 14 gusht 2018, theksojmë se ky është një

përditësim i "Factbook" si i tërë dhe jo i të dhënave specifike për Shqipërinë. Aktualisht për Shqipërinë, "Factbook" ka të njëjtën përmbajtje me atë të vitit 2017 dhe ky tekst, me ndryshime të vogla, është pothuajse i njëjtë me atë të publikuar gjatë periudhës 2007-2016. Bashkëlidhur me këtë njoftim përcjellim edhe fotot "print-screen" të faqeve përkatëse të "Factbook" sipas viteve. Spekulumet politike për të prodhuar me çdo kusht lajme negative njollosin dhe cenojnë drejtëpërdrejt punën dhe sakrificat e punonjësve të Policisë së Shtetit. Ministria e Brendshme ka qenë dhe mbetet e hapur dhe transparente me median duke informuar me korrektesë për ngjarje që kanë të bëjnë me luftën kundër paligjshmërisë e kriminalitetit", thuhet në deklaratën e Ministrisë së Brendshme.



Basha: Me luftën antikanabis Rama mashtrroi shqiptarët

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka reaguar ditën e djeshme përmes një postimi në "Facebook", në lidhje me konstatimet e CIA-s për Shqipërinë, të cilën e konsideron ende një burim të rëndësishëm për prodhimin e kanabisit si dhe një pikë aktive për transitin e drogave nga Azia Jugperëndimore. Në profilin e tij në "Facebook", akuzon kryeministrin Rama se me luftën antikanabis mashtrroi shqiptarët dhe BE, Basha shkruan se vendi nuk e meriton një kryeministër të lidhur me krimin e organizuar. "Edi Rama mashtrroi shqiptarët, BE dhe SHBA me shpalljen e fitores së luftës kundër kanabisit dhe heqjen e Shqipërisë nga harta e kultivimit të kanabisit. Nga janari deri në korrik 2018 në Itali, Greqi dhe Shqipëri janë sekuestruar 30 tonë kg kanabis shqiptar. Deri tani nuk është arrestuar asnjë bos i drogës në Shqipëri, sepse garant për paprekshëmërinë e tyre është qeveria e Edi Ramës. Ministria e Brendshme nuk bën analizat e drogës së kapur për të fshehur të vërtetën se Shqipëria vazhdon të jetë para-ja e krimin për mbjelljen e kanabisit. Analizat italiane dhe greke të drogës së kapur nga Shqipëria provojnë se kanabisi është mbjellë gjatë muajve të fundit. 30 tonë drogë e sekuestruar në 7 muaj janë vetëm maja e ajsbergut të krimin të organizuar me mbrojtje politike, që ka marrë peng vendin. Shqiptarët nuk meritojnë një kryeministër të korruptuar, që ka lidhur fatin e tij politik me krimin e organizuar"-thuhet në postimin e publikuar nga Basha.



"Misioni ynë, të shkëpusim krimin nga politika"

Alibeaj: Qeveria, policia dhe prokuroria të mos heshtin për trafikantin Mond Bego

Partia Demokratike u referua sërish ditën e djeshme biznesmenit të arrestuar në Greqi, Edmond Bego. Deputeti Enkelejd Alibeaj, në një dalje për mediat kërkoi shpjegime për këtë person edhe nga kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla. Deputeti i PD Alibeaj tha se heshtja nuk e shpëton dot Taulant Ballën duke i kërkuar të tregojë sa herë ka komunikuar me Edmond Begën. Po kështu Alibeaj e ka pyetur Ballën nëse është sekser për miliona euro punë publike të marra nga kompania e ndërtimit të narkotrafikantit biznesmen. Ai tha se policia drejtohet nga krimi dhe prokuroria nuk ka sekuestruar pasuritë e Begos në zbatim të ligjit antimafia. "Qeveria në pakt me krimin, parlamenti i varur nga krimi, policia e drejtuar nga krimi dhe prokuroria nën urdhrat e krimt po heshtin për t'i dhënë kohë numrit dy të Partisë Socialiste, që të mbulojë me harresë akuzat publike për lidhjet e tij me trafikantin e rrezikshëm ndërkombëtar të drogës, Mond Bego. Në vend që policia t'u thotë sh-



ENKELEJD ALIBEAJ

"Qeveria në pakt me krimin, parlamenti i varur nga krimi, policia e drejtuar nga krimi dhe prokuroria nën urdhrat e krimt po heshtin për t'i dhënë kohë numrit dy të Partisë Socialiste, që të mbulojë me harresë akuzat publike për lidhjet e tij me trafikantin e rrezikshëm ndërkombëtar të drogës, Mond Bego", u shpreh Alibeaj.

akuzat publike për lidhjet e tij me trafikantin e rrezikshëm ndërkombëtar të drogës, Mond Bego. Në vend që policia t'u thotë sh-

qiptarëve pse autoritetet greke kanë arrestuar dhe kanë vendosur të mbajnë në burg narkotrafikantin me lidhje politike, policia hesht.

Në vend që prokuroria të nisë menjëherë hetimet për të zbardhur arsyet e mosveprimt të Policisë së Shtetit ndaj trafikantit të shndërruar në biznesmen të fuqishëm ndërtimi, prokuroria hesht. Në vend që Edi Rama t'i kërkojë Taulant Ballës të sqarojë pozicionin e tij, Edi Rama hesht", tha Alibeaj. Deputeti demokrat deklaroi se Partia Demokratike nuk do të heqë dorë nga misioni i saj për të shkëputur krimin nga politika. "Në vend që Taulant Balla t'u përgjigjet pyetjeve, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, hesht, me shpresën se gjithçka do të harrohet. Taulant Balla dhe padroni i tij, Edi Rama, e kanë gabim. Duke përfaqësuar pjesën më të mirë dhe më të madhe të shoqërisë që nuk pranon të qeveriset nga krimi, Partia Demokratike nuk do të heqë dorë nga misioni i saj për të shkëputur krimin nga politika", u shpreh ai.

Gjykata greke e lë në burg, biznesmeni: E kam kryer dënimin në vendin tim

Arrestimi i Begos, policia: Nuk rezulton në kërkim

"Ka hyrje-dalje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në 2018"

Ina Allkanjari

Biznesmeni shqiptar Edmond Bego i arrestuar tri ditë më parë në Greqi, për llogari të shtetit italian, pasi sipas policisë greke, ndaj tij rezultoi i lëshuar një urdher për pjesëmarrje në organizatë kriminale, do të qëndrojë në burgun e Korfuzit në pritje të kërkesës për ekstradim. Ky ka qenë vendimi i dhënë nga gjykata greke ditën e djeshme, ku sipas ligjeve afati për pritjen e kërkesës nga Italia është 10 ditë. Nëse urdhrat i arrestit është në fuqi, atëherë Bego ekstradohet drejt Italisë dhe duhet të përballlet me drejtësinë atje. Nëse ky urdher ka rënë, Bego lirohet me vendim

të kryetarit të Gjykatës së Apelit në Korfuz dhe kthehet në Shqipëri. Mësohet se 48-vjeçari Bego ka pranuar për policinë greke se është personi i kërkuar, por ka deklaruar se e ka kryer dënimin. Ai u dërgua këtë të hënë në Korfuz nga Igumenica ku u arrestua në 17 gusht teksa kthehej për në Shqipëri nga ishulli ku bëri pushimet me familjen. Në lidhje me këtë çështje ka reaguar ditën e djeshme Policia e Shtetit duke theksuar se pas verifikimeve, rezultoi se shtetasi Edmond Bego, nuk është në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet policore shqiptare për llogari të ndonjë shteti tjetër.

POLICIA E SHTETIT
Për dy ditë me radhë ka një debat publik, lidhur me ndal-



imin e shtetasit Edmond Bego në Greqi. Pas verifikimeve të kryera, Policia e Shtetit sqaron se në dosjen e Kërkimit dhe Arkivës së Interpolit, shtetasi shqiptar Edmond Bego, Manoli Bego, Sajmir

Sina, Belul Gjatari, Mond Bega, 48 vjeç, nuk është në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet policore shqiptare për llogari të ndonjë shteti tjetër. Sqarohim se më herët, shtetasi Bego

është arrestuar në datë 24 dhjetor 2009 në Tiranë për llogari të drejtësisë në Itali, me urdher arresti ndërkombëtar të lëshuar në vitin 2009, nga Gjykata e Apelit të Torinos. Nga Prokuroria e Përgjithshme në datë 11 shkurt 2010 në Policinë e Shtetit ka ardhur kërkesa për njohje e vendimit penal italian nr.1735, datë 22 prill 2008, i formës së prerë të vitit 2009 dhënë nga Gjykata e Apelit Torino, Itali. Me vendimin nr. 807, datë 15 shtator 2010, Gjykata e Lartë në Shqipëri ka bërë njohjen e vendimit penal të huaj dhe ka dënuar përfundimisht me 4.4 vite burg këtë shtetas. Ai është liruar nga burgun në 24 nëntor 2011, pasi ka vuajtur rreth 1 vit e 11 muaj burgim, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila mbi bazën e

kërkesës së të dënuarit ia konvertoi pjesën e mbetur prej 1.8 vitesh burgim, në liri me kusht. Pas këtij vendimi, Policia e Shtetit nuk ka asnjë mundësi tjetër veprimi. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasi në fjalë ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018, edhe drejt Italisë. Ai në territorin italian ka hyrë 3 herë në vitin 2017, dhe në 13 korrik në vitin 2018. Bego këtë shtetas nuk ka pasur asnjë urdher tjetër ndalimi ndërkombëtar përveç urdhrat të ndalimit të ekzekutuar nga Policia e Shtetit në vitin 2009.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimtare "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 15 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimtare do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin i 1-rë, për shitjen e pasurisë nr.4/ 562/ND/17, me çmim fillestar 7.995.000 lek.

Prona me sipërfaqe 95 m² i takon z.Sami Zogji Zeqaja, ajo ndodhet pranë dyqanit të ALBITAL-CANON, Rruga Egnatia,nr.4, Durrës.

P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e derdhur në BKT, nr.illogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCALLA).

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimtare "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 01 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimtare do të shqyrtohen ofertat për ankandin e 1-rë për shitjen e pasurisë së "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës.

Pasuria përbehet nga dy dyqane (gjithej rreth 245 m²) dhe tre apartamente (gjithej rreth 245 m²) dhe mbi këto prona nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 54.000 lek/m², ndërsa çmimi fillestar për dyqanin do të jetë 81000 lek/m².

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimtare "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 17 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimtare do zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë nr.58/96, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Tërshi që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshjeje sipërmarrje.

Prona është e vëllëzëve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Çmimi fillestar me të cilin hapet ankand do të jetë 48735000 lek.

Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.

Ofertuesit duhet të kenë depozituar në illogarinë e zyrës përbarimtare 10% të çmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

OPOZITA INTERVISTA

Deputetja e PD: Me mazhorancën s'mund të ketë dialog kur ka qenë e prirur t'ia mbyllë gojën opozitës me dhunë

Tabaku: Milionat në xhepat e qeverisë, qytetarët pa shërbime

"500 mln euro për të bojatisur qendra bosh qytetesh"

Valentina Madani

Deputetja demokratike Jorida Tabaku zbardh strategjinë e PD-së për rrëzimin e qeverisë "Rama" duke garantuar se opozita do të jetë zëri që do të përballet me ashpërsi përballë kokëfortësisë dhe keqdashësisë së qeverisë. Tabaku thotë për "Gazeta Shqiptare" se me mazhorancën, e cila ka prirjen t'ia mbyllë gojën opozitës, nuk mund të ketë një dialog. Sipas saj konsensusi që kërkoi Kryeministri Rama mund të vijë vetëm duke respektuar Kushtetutën, askush nuk ka ndërmend t'i japë pushtet absolut kryeministrit Rama për të vazhduar i pasqetësuar kapjen e sistemit. Tabaku flet edhe për ngërçin në gjyqësor tekta akuzon qeverinë për përvetësim të sistemit ndërkohë që shtron pyetjet: Pse nuk alokohen më shumë fonde për institucionet e vetingut siç kanë kërkuar? Pse nuk ngrihet SPAK dhe Byroja e investimit që janë kërkesa kryesore në luftën ndaj korrupsionit dhe plotësimit të kriterëve për hapjen e negociatave? Sistemi, shprehët Jorida Tabaku, është duke u shndërruar në një agjenci të qeverisë. Nënkrjetarja e Komisionit kuvendor të Ekonomisë akuzon qeverinë për shpenzime të tepruara, ndërkohë që shqiptarëve nuk u ofrohen shërbimet e duhura.

Zj. Tabaku, opozita po përgatitet për aksionin e ri politik por çfarë surprizash do të shohim në shtator, si brenda dhe jashtë Kuvendit?

Për gjatë gjithë muajve të verës opozita ka vazhduar evidencimin dhe denoncinimin e lidhjeve korruptive dhe mafioze të qeverisë dhe mazhorancës në pushtet. Raporti i KLSH, evidencimi i korrupsionit, lidhjet e mazhorancës me bandat e kriminelëve janë pasqyruar përditë në sy të qytetarëve. Sikundër edhe raporti i qeverisë me problematikën e vetingut, se si kryeministri



Deputetja e PD Jorida Tabaku

Rama po përdor vetingun për të kapur sistemin e drejtësisë. Shtatori, për nga dinamika, natyrisht që do të jetë më konfrontues duke qenë se fillon dhe sesioni parlamentar. Pa harruar që qeveria ka shumë tema të nxehta me të cilat duhet të dalë para publikut, ku një ndër të është edhe çështja e prishjes së Teatrit Kombëtar për t'i dhënë udhë kullave. Në Kuvend dhe jo vetëm, opozita do të jetë zëri që do të përballet me ashpërsi përballë kokëfortësisë dhe keqdashësisë së qeverisë.

Një ftesë e hapur për dialog, mazhoranca e la të hapur për opozitën sesionin që shkoj, por si i shihni thirrjet e PS-së për bashkëpunim?

Nuk mund të ketë një dialog në çastin kur mazhoranca dhe qeveria kanë qenë të prirura që të mbyllin gojën e opozitës me dhunë. Dialogu mund të mirëkuptohej si ofertë ditën që mazhoranca do të kërkonte një zgjidhje kushtetuese për Prokurorin e Përgjithshëm, por përderisa qeveria vendosi të bëjë një emërim politik, përderisa vazhdon të nxjerrë ligje edhe duke mos pasur Gjykatë Kushtetuese, përderisa vazhdon të ruajë të njëjtat lidhje me të inkriminuarit, atëherë kjo nuk ka vlerë. Përkundrazi, dialogu sot më së shumti është një tentativë për t'i ikur

"Qeveria ka shpenzuar 500 mln euro për të bojatisur qendra bosh qytetesh, por vetëm 11 mln euro për të ndërtuar vetëm 2 km rrugë këto 5 muaj të parë të vitit. Po shpenzon 90 milionë euro në koncesione çdo vit, por po dështon të ofrojë shërbime shëndetësore falas ashtu siç premtoi", deklaroi deputetja e Kuvendit të PD-së.

përgjegjësive të qeverisë. Për t'ia hedhur një pjesë të mirë të fajit në shpinën e opozitës që nuk është aspak fajtorë për situatën ku e ka çuar vendin qeveria. Kryeministri Rama para një viti kërkoi timonin e qeverisë ndërsa në si opozitë kërkua qeverisjen e Shqipërisë përmes një programi. Fatqeqësisht sot shqiptarët po e përjetojnë e shohin se fushata ishte thjeshtë propa-

gandë.

Parlamenti dështoi në votimin për disa ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat synojnë t'i hapin rrugë pranimë të reja në shkollë e magistraturës dhe emërimëve të magistratëve të rinj të diplomuar tanimë. Shkak është bërë opozita. Konkretisht si mund të zgjidhet ngërçi me Shkollën e Magistraturës? A do japë opozita konsensus për miratimin në Kuvend?

Opozita dhe për më tepër kryetari i Partisë Demokratike, Z. Basha, është shprehur qartë mbi këtë temë. Nuk mund të kemi një votim me 84 vota vetëm në rastin kur do të kemi ndryshime të nevojshme në ligjet e miratuara në kundërshtim me Kushtetutën në lidhje me reformën në drejtësi. Janë këto ligje të bëra shkel e shko, në këndvështrimin tonë, që kanë sjellë deri në këtë pikë procesin e vetingut dhe krijimin e institucioneve të reja. Kërkesa e qeverisë drejtuar opozitës është përpjekje e qartë për të na vendosur mbi shpatulla një faj që nuk na takon. Ende i freskët është kujtimi i gushtit të tre viteve më parë kur qeveria votoi në mes të vapës së gushtit disa ligje që ishin në kundërshtim me ndryshimet Kushtetuese

KONCESIONET

"Kontratat koncesionare që po jepen nën logjikën e PPP-ve janë qoka të qeverisë që i shpërndahen kompanive pranë saj. Këto kompani që fitojnë PPP-të në shumicën dërrmuese të rasteve janë kompani fantazmë, kompani të lidhura me offshore apo kompani që nuk kanë eksperiencën e nevojshme", theksoi Jorida Tabaku.



qeverisë.

Pse sot Shqipëria është pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë? Kam parasysh këtu që Gjykata Kushtetuese është aktualisht jashtë loje. Drejt të njëjtë fat rrezikon të shkojë dhe Gjykata e Lartë, e cila tashmë funksionon me numër të kufizuar të anëtarëve të saj, ndërsa mungesa e Këshillit të Lartë të Prokurorisë po mban pezull dhe Byronë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-un ose Njësinë Speciale AntikorruptSION.

Në Shqipëri ka ndodhur ajo që zakonisht ndodh në vendet që janë një hap larg diktaturës. Procesi me dy standarde i vetingut nisi duke zhbërë Gjykatën Kushtetuese, ndërkohë që ende nuk qe ngritur asnjë gjykatë tjetër që të marrë funksionet e saj. Përse? E thjeshtë, me një Gjykatë Kushtetuese funksionale shumë ligje që sot qeveria kalon pa teklif, nuk do të kalonin. Qeveria e hoqi këtë guralec nga këmba që të mos ketë asnjë zë kundër saj që të flasë apo të shprehë në formë të prerë. Përmes vakumit që ka krijuar ajo mund të qeverisë njësoj si diktatorët e dikurshëm, pa t'u përgjigjur dhe pa i dhënë llogari askujt. Tani kur një kryeministër zhbën institucionin më të lartë të gjykatës mundet që të dëshirojë krijimin e Byrosë së Hetimit dhe SPAK' Natyrisht që jo! Sidomos pasi kjo qeveri ka dosje hetimi për check up, largimin e Nazer Seitit, dy ministra rendi të përfshirë në trafik droge, anëtarë të mazhorancës të ngatërruar



"Vakumi në gjyqësor, Rama mund të qeverisë si diktatorët e dikurshëm, pa i dhënë llogari askujt"

Deputetja e PD: Konsensus vetëm kur të respektohet Kushtetuta

"Gjyqësori, po shndërrohet në një agjenci të qeverisë"

qën nga duart në një formë të çuditshme, u bë levë e qeverisë në arrestimin e protestuesve kuksianë ndërkohë që vëllai i ministrit Xhafaj hyri dhe doli në dyert e prokurorisë sikur asgjë s'ka ndodhur. Qartazi zonja Marku është më e politizuar se sa thuaje çdo paraardhës i saj dhe vazhdon të luajë të njëjtën lojë të qeverisë.

Ka shifra kontradiktore për shpenzimet e qeverisë, por realisht sa ka shpenzuar qeveria "Rama"?

Qeveria Rama do të mbahet mend si qeveria që rriti taksat dhe nuk ofroi asnjë shërbim. As rrugë, as shkolla, as qendra shëndetësore. Për më tepër nuk rriti pagat e pensionet, nuk rriti shpenzimet në arsim, por rriti tarifat e arsimit të lartë, nuk arriti investimet në energji, por rriti çmimin e energjisë elektrike. Por më e rëndësishmja do të mbahet mend si qeveria që nuk diti të ofrojë asnjë shërbim dhe çdo gjë t'ia kalonte privatit me koncesion. Ka shpenzuar 500 mln euro për të bojtatur qendra bosh qytetesh por vetëm 11 mln euro për të ndërtuar vetëm 2 km rrugë këto 5 muaj të parë të vitit. Po shpenzon 90 milionë euro në koncesione çdo vit, por po dëshon të ofrojë shërbime shëndetësore falas ashtu siç premtoi.

PD gjatë këtyre muajve ka vijuar me denoncimin e aferave korruptive përfshi dhe koncesionet ku sipas demokratëve PPP janë akti pastër korruptiv në Shqipëri. Realisht në ç'menyrë po grabiten shqiptarët?

Kontratat koncesionare që po jepen nën logjikën e PPP-ve janë qoka të qeverisë që ishpërndahen kompanive pranë saj. Këto kompani që fitojnë PPP-të në shumicën dërrmuese të rasteve janë kompani fantazmë, kompani të lidhura me offshore apo kompani që nuk kanë eksperiencën e nevojshme. Le të marrim rastin e inceneratorëve në Shqipëri, një prak-



PROTESTA

"PD-ja ka dëshmuar dhe ka treguar që mund të mbledhë mijëra qytetarë për t'i treguar vendin kryeministrit Rama që përherë ka ikur nga Tirana gjatë këtyre protestave. Unë besoj dhe shpresoj që shqiptarët do të ndërgjegjësohen edhe më shumë e do t'i mbushin rrugët e vendit",-deklaroi deputetja e PD.

tikë, e cila është PPP, por që rezulton nga të dhënat e qarta se është aferë korruptive. Për t'i dhënë këtë PPP qeveria është angazhuar që të kalojë brenda një dite rreth dhjetë vendime të Këshillit të Ministrave një kompanie të krijuar disa ditë përpara fitimit të PPP-së për ndërtimin e inceneratorit. E njëjta skemë është përdorur në çdo PPP tjetër të dhënë nga qeveria. Por nuk është vetëm kaq. Skema e PPP-së, sikundër vëren edhe FMN me të drejtë, është duke u përdorur pa kriter dhe pa matje efieience. Askush nga qeveria nuk ka kryer një analizë efieiente për këto PPP të dhëna; pra se sa i shërbëjnë qytetarëve se sa të dobishme janë. Le të marr një shembull për këtë rast, qeveria ka shpallur se do të ndërtojë me PPP rrugën Dhërmi-Orikum që do të shkurtojë shumë kohën e qarkullimit mes dy zonave. Por nga ana tjetër qeveria nuk ka shpenzuar asnjë qindarkë për rrugët që duhet të ishin mbyllur e kohë në atë zonë, sot nuk ka përfunduar ende unaza e Vlorës dhe qytetarët rraskapiten në radhë kilometrike në të

famshmen Lungomare që nuk është ndërtuar për atë trafik. Po kështu qeveria ende pas pesë vjetësh nuk ka përfunduar bypass-in e Fierit që do ta lidhë me autostradën Levan-Vlorë duke agruar situatën e trafikut. Pa përfunduar asnjë nga këto akse kryesore qeveria shpik një aks të ri që nuk është i dobishëm për qytetarët që do të vazhdojnë të vruajnë trafikun edhe pas kësaj shkurtimi të kohës në rrugën Dhërmi-Orikum. Së fundi, vlera e këtyre PPP-ve është mbi normat logjike. Kostot e rrugëve të dhëna me PPP tregojnë se ato janë dhjetëfishuar dhe se ky dhjetëfishim nuk ka sjellë rrugë më të mira. Le të mos harrojmë që rruga më e kushtueshme në vend është Rruga e Kombit e ndërtuar nga kompania me emër botërisht si Bektelenka, këto kompani nuk vijnë më në Shqipëri pasi qeveria ka paracaktuar fituesin e tenderit dhe njëkohësisht edhe pagesën që do të merret. Ndërkohë që rrugë si ajo e kombit në Shqipëri ende nuk janë ndërtuar ndonëse kostoja e rrugës është dhjetëfishuar nga viti 2013.

FTESA

Deputetja e PD-së tha se: "Nuk mund të ketë një dialog në çastin kur mazhoranca dhe qeveria kanë qenë të prirura që të mbyllin gojën e opozitës me dhunë. Përkundrazi, dialogu sot më së shumti është një tentativë për t'ikur përgjegjësive të qeverisë".

Mijëra demonstrues kanë mbushur rrugët e Bukureshtit për të kërkuar dorëheqjen e qeverisë rumune të social-demokratëve, por a presim një skenar rumun edhe në Shqipëri?

Rumunët kanë zbritur në shesh pasi në Rumani është krijuar SPAK dhe kryetarja e SPAK ka filluar të çojë përpara përgjegjësitë qeveritarët e korruptuar. Pikërisht kësaj i trembet kryeministrit Rama, pasi të gjithë e dimë që lidhjet e tij me oligarkët shqiptarë dhe jo vetëm mund t'i kushtojnë shtrenjtë. Ndaj ka zgjedhur të emërojë njerëz të besuar dhe të kontrollojë sistemin gjyqësor. Në Rumani nuk janë ngritur vetë forcat politike opozitare por e gjithë shoqëria, përfshirë edhe shoqërinë civile. Partia Demokratike ka dëshmuar dhe ka treguar që mund të mbledhë mijëra qytetarë për t'i treguar vendin kryeministrit Rama që përherë ka ikur nga Tirana gjatë këtyre protestave. Unë besoj dhe shpresoj që shqiptarët do të ndërgjegjësohen edhe më shumë e do t'i mbushin rrugët e vendit. Shihni protestën për mbrojtjen e Teatrit, një protestë e mrekulueshme që ka muaj që kryhet dhe për të cilën media jonë flet pak ose aspak. Ata janë të ngjashmit me protestën civile në Bukuresht, ndonëse të pakët në numër, por shumë të drejtë në kauzën e tyre.

GJYQËSORI
"Sot kemi një sistem të kolapsuar, gjykatat më të rëndësishme në vend janë jashtë funksioni dhe kemi një proces veting që po përdoret për presione politike. Miratimi i këtyre ndryshimeve nuk ka absolutisht lidhje me reformën në drejtësi. Sot reformën në drejtësi po e pengon qeveria", - tha zj. Tabaku.

me grupe kriminale, koncesione abuzive e kështu me radhë. Kush i ka duart e pista nga korrupsioni, droga, kanabizimi, vjedhja e kështu me radhë nuk mundet të dëshirojë dhe mundësojë krijimin e mekanizmave të pavarur që do të hetojnë atë dhe njerëzit e tij.
Si e shikoni drejtimin e Prokurorisë së Përgjithshme nga Arta Marku dhe a po shkon ajo nga kryeprokurore e përkohshme, drejt kryeprokurores së përhershme? Si mund ta ndërpresë opozita mandatin e saj?

Zonja Marku është një emërim qartësisht politik, u zgjodh në krye të prokurorisë jo vetëm në kundërshtim me kushtetutën (e cila nuk përmend gjëkundë PPP-në), por edhe me më pak vota se sa një ministër. Në kushte të një parlamenti në kaos, institucioni që ajo përfaqëson dhe integriteti i saj nuk du-

het ta kishin lejuar të betoheshin në ato kushte në Kuvend. Prokuroria nuk është një agjenci e qeverisë, nuk është një zgjatim i kryeministrit Rama apo ministrit Xhafaj, përkundrazi është institucioni i pavarur. Por, siç historia na ka mësuar, PS nuk e ka për herë të parë politizimin e institucioneve pasi plot njëzet vite më parë zgjodhi të bënte të njëjtin gjë me z. Abdiu që e emëroi nga deputet të saj në krye të një institucioni të pavarur. Sakaq, puna e zonjës Marku është për të ardhur keq pasi ajo mbahet mend si Prokuroria e Përgjithshme e përkohshme që kundërshtoi vetë frymën me të cilën kish të ardhur në krye. Së pari, nuk duhet të bënte emërimet që ka kryer bashkë me shkarkimet. Së dyti, gjatë kohës së saj në krye të prokurorisë i vodh dy herë prokuroria e Durrësit, dëshmitari kyç Nazer Seit i ha ho-

NJOFTIM ANKANDI
Me date 17.08.2018 Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme e llojit: Nderësse, Kati i parë i përbërë nga dy dhoma banjo korridor salton dhe balkon me sip.123 m², me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592 Laj.Naim Gjilbegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder
Çmimi filluesar për Shitjen ne Ankan është ne vleren 5,707.200 leke (Pesë milion e shtatëqind e shtata mila e dyqind leke)
Shitja e pasurisë do të behet,(zhvillohet) ne ambientet e Zyres se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli,me adrese Laj."Qemal Stata".Rr."Don Bosko", dhe do te perfundoje me dt.16.09.2018 ora 16:00 (me perfundimin e orarit zyrtar)
Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raifaisen-Dega Shkoder
Çfiteruesit te drogethen pranë Zyres se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli ,ose te kontaktone nepermjete Nr.tel 0692219253 ose adresses se emaili. ermira.mhilli@hotmail.com

NJOFTIM ANKANDI
Me date 17.08.2018 Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme e llojit: Nderësse, Kati i parë i përbërë nga dy dhoma banjo korridor salton dhe balkon me sip.123 m², me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592 Laj.Naim Gjilbegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder
Çmimi filluesar për Shitjen ne Ankan është ne vleren 4,718.880 leke (Katër milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mila e tetëqind e tetëdhjeta)
Shitja e pasurisë do të behet,(zhvillohet) ne ambientet e Zyres se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli,me adrese Laj."Qemal Stata".Rr."Don Bosko", dhe do te perfundoje me dt.16.09.2018 ora 16:00 (me perfundimin e orarit zyrtar)
Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raifaisen-Dega Shkoder
Çfiteruesit te drogethen pranë Zyres se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli ,ose te kontaktone nepermjete Nr.tel 0692219253 ose adresses se emaili. ermira.mhilli@hotmail.com

SHPLLJE ANKANDI
Datë 21.08.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adrese Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404306426, Col. 067 201 0460/068 504 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të dorëzansëve Petrit Sami Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:
"Aparamenti" me sipërfaqe 54 m², nr.i pasurisë 1126/v1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lajga "Gjokë Doçi", Peshkopi, Dibër.
Çmimi filluesar i ankandit të parë është në shumën 1 600 000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adrese: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

QEVERISJA KRITIKAT

Vasili: Të ngrihemi në këmbë kundër maskarallëkut shtetëror të rilindjes

LSI: Edhe Shqipëria si Italia, mosbindje civile për koncesionet

"Kryeministri rrahu kuksianët, nuk ndalemi"

Valentina Madani

LSI përmes kreut të grupit parlamentar Petrit Vasili ftoi dje qytetarët shqiptarë që të ngrihen në mosbindje civile deri në rrezimin e qeverisë "Rama". Sipas tij qeveria e zullumeve në kurriz të shqiptarëve duhet të marrë fund. Kreu i deputetëve të LSI-së Petrit Vasili komentoi dje deklarimet e drejtuesit të partisë italiane 5 Yjet, Beppe Grillo, për mosbindje civile për mos pagimin e autostradave italiane. Vasili shkruan se edhe në Shqipëri, mosbindja civile është më e pakta që mund të bëhet përpara posttërsive që u bëhen qytetarëve shqiptarë. Ai kujtoi edhe rrahjen që qeveria "Rama" u bëri banorëve të Kukësit, të cilët kundërshtuan vendosjen e pagesës në rrugën e Kombit. "Italia mosbindje civile për koncesionet, ndërsa në Shqipëri mosbindja civile duhet të mos ndalet... Drejtuesit të partisë 5 Yje që qeverisë Italinë Bepe Grillo deklaroi mosbindje civile për të mos paguar autostradat në Itali dhe se do të jetë vetë në rreshtin e parë të mosbindjes civile

Po hajdutët e deklaruar botërisht të qeverisë shqiptare duke filluar nga kryeministri ç' bëjnë", shprehet Vasili. Zyrtari i lartë i LSI-së përmend me tej: "Rrahjen kuksianët për Rrugën e Kombit dhe deklaruan se do të vënë pagesën edhe për rrugët e tjera". Sipas Vasilit, mosbindja civile është legjitime dhe më pakta në Shqipëri përpara kësaj posttërsie që i bëhet qytetarëve të varfër dhe të vobektë shqiptar". Kreu i grupit parlamentar të LSI-së kujton se "Kur Italia e pasuri i ka koncesionet gur në qafë dhe po i anulon këto koncesione mendoni këta hajdutet tanë të qeverisë që duan t'i vënë gjithandej.

Ai fton ndjekësit e tij që të lexojnë çfarë thotë Bepe Grillo.



lo: "Ne, baballarët dhe gjyshërit tanë i kemi paguar autostradat. Kostoja e tyre është amortizuar prej vitesh. Në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani, autostradat janë falas. Në këto vende, në mënyrë legjitime, qytetarët i përdorin pa i paguar dy herë. I kanë fi-

nancuar sërish, sepse janë të tyret tashmë. Në Itali, autostradat u janë dhuruar koncesionarëve si "Benetton", që fitojnë miliarda euro pa asnjë risk dhe pa investime kapitale". Nuk kemi paguar taksa për dekada me radhë për të pasuruar "Benetton"-in dhe ortakët e tij.

MOSBINDJA
"Italia mosbindje civile për koncesionet, ndërsa në Shqipëri mosbindja civile duhet të mos ndalet..." tha z.Vasili. Ai komentoi dje deklarimet e drejtuesit të partisë italiane 5 Yjet, Beppe Grillo, për mosbindje civile për mos pagimin e autostradave italiane.

Për autostradat e reja, diskutimi është tjetër. Kush do koncesionet, të paguajë nga paratë e veta", thotë Grillo. Kurse Petrit Vasili apelon për shqiptarët: "Të ngrihemi në këmbë kundër maskarallëkut shtetëror të rilindjes, mosbindja civile është më e pakta.

Akademia politike në Jalë, LRI nis aktivitetin e përvitshëm

Kryemadhi-Ramës: S'na kopjoni dot, të rinjtë e LRI debatojnë ditë e natë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, njoftoi dje nisjen e kampingut të organizuar këtë vit në Jalë nga të rinjtë e LRI-së. Në një postim në "Facebook", Kryemadhi "thumbon" socialistët se kanë tentuar të huazojnë traditën e LRI-së. Marrë shkas nga organizimi i pak ditëve më parë i të rinjve të FRESSH në Jalë, Kryemadhi shprehet se forumet e tjera nuk arrijnë dot të kopjojnë aksionin e LRI-së, ku sipas saj, debatet dhe diskutimet nuk resh-



tin as në drekë e as në mbrëmje. "Ka nisur kampingu politik i të rinjve të LSI-së, një traditë e bukur e huazuar dhe nga forumet e tjera të ngjashme, të cilat megjithatë nuk kanë mundur të "kopjojnë" dot aksionin dhe motivimin tonë, ku debatet dhe diskutimet nuk rreshtin as në orët e nxehta të ditës dhe as në ato të mbrëmjes. Këto janë ditët kur të rinjtë mësojnë vlerat e politikës, por jo vetëm. Janë ditët kur ata "stërvenin" për të qenë mbi të gjitha njerëz të mirë dhe qytetarë të ndershëm", shkruan zj.Kryemadhi në "Face-

book". Pas kampit të të rinjve socialistë në fund të korrikut është ajo e të rinjve të Lëvizjes Socialiste për Integrim që si çdo vit organizojnë aktivitetin e Akademisë në Jalë që këtë vit zhvillohet në datat 20-25 gusht. Të rinjtë do të kalojnë 5 ditë, ku misioni kryesor është socializimi dhe zbulimi i elementeve që dëshirojnë të shpikatin politikisht. Gjatë gjithë ditës do të zhvillohen takime dhe trajnime të ndryshme me politikanë, diplomat, gazetar dhe ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët do të ndajnë diskutimet e tyre dhe do t'i përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të LRI-së. Në kamp të rinjtë do të ndajnë eksperiençën e të jetuarit në komunitet. Ku çdo punë dhe shërbim gjatë qëndrimit në kamp do të kryhet nga vetë të rinjtë për të rritur tek ata sensin e përgjegjshmërisë.



THIRRJA

Kreu i deputetëve të LSI-së Petrit Vasili apeloj dje për qytetarët shqiptarë: "Të ngrihemi në këmbë kundër maskarallëkut shtetëror të rilindjes mosbindja civile është më e pakta".



"Si përdhosen një rrugë..."

Berisha: Edi Rama i vendos emrin e vet një rrugë në Surrel

Kryeministri Rama ka filluar t'u vendosë emrin e tij rrugëve të Surrelit. Një gjë të tillë e bëri të njohur nga një qytetar, i cili i ka dërguar ish-Kryeministrit Berisha edhe fotot e marra nga "Google". Berisha, jo pa ironi, shkruan se "shikoni foton si përdhosen me emrin e tij një rrugë në Surrel!" "Flasin vetë! Lexoni mesazhin dhe foton si përdhosen me emrin e tij një rrugë në Surrel!" Përsëhendjet Doktor! I sëmuri psiqik ka filluar të vendosë dhe emra rrugësh me emrin e tij. Konkretisht të "vilajet" në Surrel. E mësova lajmin në "Fb" dhe hyra në Google map për ta verifikuar, se mos vallë ishte montazh. Dhe rezultoi më se i vërtetë. Besoj se ju duhet të jeni i informuar për këtë gjë. Unë gjithsesi po ju dërgoj edhe scrë shot-in", thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.

EPSA SHOQERIA PËRMBARËSE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

1- "Plll e Kullote" me sip. 280.000 m2, Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Porç, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Cmiri me të cilin fillon ankandi është **3.360.224 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **07.09.2018 ora 16.00** në adresën Rr."I. Qemal", Pall. "Fratar", K.6,Tirane.

2- "Plll e Kullote" me sip. 95.000 m2, Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Porç, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Cmiri me të cilin fillon ankandi është **1.140.076 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **07.09.2018 ora 16.00** në adresën Rr."I. Qemal", Pall. "Fratar", K.6,Tirane.

Per çdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Raporti i INSTAT për janar-mars 2018

Paga mesatare mujore zhvlerësohet me 3 % ose 1468 lekë

Paga mesatare në ekonomi i është kthyer rënies përgjatë tremujorit të parë të vitit, duke konfirmuar edhe njëherë që ekonomia e vendit po i largohet gjithnjë e më shumë produktivitetit. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, paga mesatare mujore në ekonomi u ul në janar-mars 2018 me 3 për qind ose 1468 lekë më pak. Kështu paga mesatare mujore për një të punësuar në Shqipëri arrihi në 49,145 lekë nga 50,614 lekë që ishte në fund të vitit 2018. Në të njëjtën masë, 3 % raportotet edhe rënia e pagës mesatare në sektorin publik, e cila në tremujorin e parë të 2018 shkoi në 59,728 lekë, nga 61,600 lekë që ishte në fund

të vitit. INSTAT për përcaktimin e pagës mesatare në shtet ka nisur të marrë si reference të dhënat nga listë pagesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, më parë këto të dhëna merreshin nga pasqyrat e programit statistikor. Më të dhënat zyrtare pagat kanë pësuar rënie në tremujorin e parë, teksa tatimet nisën një aksion në të gjithë vendin. Drejtorja e riskut në Tatime njoftoi javën që shkoi se ka filluar të marrë në analizë nivelin e deklarimit të pagave të punonjësve për profesione të ndryshme, duke i krahasuar me pagat reale të tregut të punës. Nga



këto analiza, është konstatuar se disa punëdhënës deklarorinë paga, për profesione të caktuara, që janë ndjeshëm nën nivelin mesatar të tregut apo janë afër pragut të pagës minimale të

përcaktuar për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Punësimi në Shqipëri po përmirësohet, por vendet e reja të punës janë me produktivitet të ulët. Banka

e Botërore zhvilloi një anketë për shpërndarjen e vendeve të reja të punës në periudhën 2014-2016 dhe gjeti se rritja e punësimit ishte e shoqëruar me një ofertë punë që kërkon kualifikim shumë të ulët. Me fjalë të tjera, megjithëse u krijuan vende të reja pune (punësimi u rrit me 11 për qind në periudhë, ose 114,000 vende pune), këto punë të reja ishin, mesatarisht, më pak produktive sesa vendet ekzistuese të punës. Për pasojë Shqipëria ka nivelin e pagave më të ulët në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërmjet viteve 2015 dhe 2016, rritja e punësimit ishte më e madhe në prodhim me (27 %), ndjekur nga bujqësia (18 %), tregtia (19 %), shërbimet e biznesit (14 %), TIK (10%) dhe turizmi (7%)



Qeveria planifikon të ulë shpenzimet për arsimin

Teksa Shqipëria paraqitet me nivelin më të ulët aftësive në tregun e punës në raport me vendet e tjera të rajonit, shpenzimet për arsimin në raport me PBB në vend që të rriten do të ulen më tej gjatë viteve në vijim. Sipas planifikimit afatmesëm të Ministrisë së Financave, shpenzimet për arsimin nga 3.1%- 3.3 për qind e PBB-së më 2018-2019 do të zbrisin në 3 % në 2020 dhe 2021. Shpenzimet për arsimin parashikohen me ulje edhe pse Shqipëria u rendit e fundit në Rajon për shpenzimet dedikuar arsimit gjatë vitit të kaluar. Shqipëria shpenzoi 3.1 për qind të PBB-së për arsimin teksa vendet e tjera të rajonit ky tregues është në intervalin 4-4.5% të PBB-së. Ministria e Arsimit do të financojë me prioritet gjatë viteve në vijim transportin e 28-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 10 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë.

cionit kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesit kryhet nëpërmjet informimit me email, dërgimit të përgjigjes elektronike të "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-albania", si dhe me shërbim postar nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër.

"Premtim i mbajtur", ministrja Etilda Gjonaj komenton dhënien e certifikatave

Ornela Manjani

Lëshohen certifikatat e para të pronave në Dhërmi

Zona ka 815 pasuri me një sipërfaqe rreth 30,708 m2

Për herë të parë në fshatin Dhërmi janë lëshuar certifikatat e pronësisë, për 815 prona që ka ky fshat, në një zonë shumë të lakmuar për vlerat turistike të tij. Gjithçka është bërë e mundur pas përfundimit të regjistrimit fillestar të pronave nga ana e Zyrës vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Lajmi është bërë i ditur nga ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj e cila në një postim në faqen e saj zyrtare, e konsideron këtë një tjetër premtime të mbajtur: "Janë dhënë certifikatat e para të pronësisë për fshatin Dhërmi. Rreth dy javë më parë, gjatë hapjes të zyrës së re të ZRPP në bashkinë Himarë, ju premtuam banorëve të fshatit Dhërmi, së bashku me kolegun Gjikonuri, se brenda muajit gusht procesi i regjistrimit fillestar i pronave të tyre do të kishte përfunduar si një premtime të bërë më herët", shkruan ministrja Gjonaj.



protonësisë. Ministrja Gjonaj thotë në mesazhin e saj se objektivi kryesor është regjistrimi fillestar i të gjitha pasurive në vend, si një

proces i rëndësishëm në reformën e pronës. REGJISTRIMI NË E-ALBANIA Ndërkohë që lejet e legali-

zimit mund të regjistrohen në Hipotekë brenda 10 ditëve me një kosto prej 5 mijë lekësh pa qenë nevoja të prisni ALUJZNI-n të dorëzojë dosjen në hipotekë. Pronësit që kanë ndërtuar pa leje dhe janë pajisur me lejen e legalizimit, mund të marrin tapinë për shërbimet që ofrohet në "e-albania". Pronari i objektit duhet të identifikohet në faqen zyrtare në internet me numrin e kartës së identitetit ose pasaportë biometrike (të nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-albania") dhe të dërgojë një shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar lejen e le-

galizimit. Shërbimi elektronik në faqen e-albania u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrimin e objekteve të legalizuara. Behet regjistrimi i objektit të legalizuar menjëherë pas përcjelljes për regjistrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, të lejes së legalizimit dhe dokumentacionit. Regjistrimi kryhet në favor të subjektit, të cilit i është lëshuar leja e legalizimit. Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informa-

Tatimet: Deklaroni të ardhurat nga qiraja e apartamenteve, po ju kontrollojmë

Drejtorja e Përgjithshme të Tatimeve njofton personat e pargjistruar në lidhje me detyrimin për të deklaruar dhe paguar tatimin mbi të ardhurat e përfuturora nga dhënia me qira e shtëpive apo apartamenteve. Gjatë sezonit turistik, Administrata Tatimore njofton se i ka kushtuar vëmendje të veçantë, garantimit të përbushjes vullnetare të këtij detyrimi nga ana e individëve, të cilët shfrytëzojnë këto mjedise për pushimet verore. AT, në bashkëpunim edhe me insti-

organin tatimor përkatës tatin me masën 15% të të ardhurave të realizuara, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Deklarimi kryhet vetëm elektronikisht, sipas hapave të mëposhtëm: Hyni në faqen zyrtare: eee.tatime.gov.al, mënyrë "e-Shërbime" zgjidhet rubrika "individë", në të cilën klikohet për të aksesuar logarinë e deklarimit elektronik, hapni dritaren e aksesimit në logari, ku si emër përdoruesi vendoset numri personal (sipas Kartës së Identitetit dhe jepet



fjalëkalimi përkatës). Për të aksesuar logarinë, duhet të zgjidhet: "E lexova dhe bie dakord me termat dhe kushtet". Me hyrjen në logarinë, mënyrë "Deklarata" zgjidhet "Tatimi në Burim". Tek rubrika "Deklarata të padorëzuara" listohen deklaratat, që duhet të plotësohen dhe zgjidhet periudha për të cilën do të kryhet deklarimi. Individit përfuturës i të ardhurave, plotëson rubrikën 15 "Pagesat për qiratë" të deklarates së tatimit të mbajtur në burim, duke hedhur shumën mujore të përfutur nga qiratë dhe tatimin e logaritit në masën 15%. Duke klikuar butonin "Dorëzo", deklarimi përfundon dhe dorëzo-

het në Administratën Tatimore. Pas dorëzimit, deklarata mund të printohet për efekt dokumenti, duke klikuar butonin "Printo". Për kryerjen e pagesës, individit, përfuturës i të ardhurave, mënyrë "Deklarata të dorëzuara", zgjedh periudhën përkatëse dhe shtyp butonin "Printo Urdhër Pagesë". Ky urdher i printuar shërben për të kryer pagesën në sportelet e bankave të nivelit të dytë. Drejtorja e Përgjithshme të Tatimeve u kujton tatimpaguesve se përbushjes vullnetare e detyrimeve, përveçse është një detyrim ligjor, vlerësohet edhe si një akt qytetar, të vullnetit për forcimin e shtetit ligjor.

Operacioni, policia shpall në kërkim dhe 2 të tjerë

Shkatërrohet grupi i kultivimit të kanabisit, arrestohen 7 persona, mes tyre dhe organizatori

KORÇË - Policia e Korçës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi, pas një hetimi disa mujor ka goditur një grup kriminal në fushën e kultivimit të narkotikëve. Shtatë persona kanë përfunduar në pranga, ku mes tyre është dhe organizatori i grupit, ndërsa janë shpallur në kërkim dy të tjerë. Mësohet se operacioni është ndjekur me metoda speciale hetimi, përmes përgjimit, vëzhgimit, kamuflimit dhe agjentëve policorë të atashuar në zonën ku ishte planifikuar të zhvillohej aktiviteti kriminal në fshatin Velçan. Sipas burimeve nga policia, hetimi inten-



siv nisi me regjistrimin e çështjes në prokurori dhe mbajtjen në vëzhgim të personave të dyshuar që posedojnë dhe po merreshin në terren me mbjelljen dhe kultivimin e bimëve të kanabisit. Qëllimi ishte, ashtu siç u finalizua gjatë opera-

cionit policor, të goditeshin jo vetëm kultivuesit, por edhe organizatorët dhe sponsorizuesit e këtij aktiviteti kriminal", u shpreh burimet e mësipërme. Shtetasit e arrestuar janë: Selman Bitaj, 40 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale "Prodhimi dhe

shitja e narkotikëve", (në rolin e organizatorit); R.B, 17 vjeç (kultivues); Poliksen Haxhiraj, 25 vjeç (kultivues); Armand Pashollari, 30 vjeç (kultivues);

Jani Ibrahimllari, 49 vjeç (kultivues); Vendim Fejzaj, 27 vjeç, (kultivues) dhe Ligor Fejzaj, 56 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", të cilit iu gjet dhe sekuestrua një armë tip "Shotgun", pa leje (në rolin e rojes).

Gjithashtu, u bë shpallja në kërkim dhe po punohet për kapjen e shtetasve: N.I, 36 vjeç (organizator) dhe E.Ç, 26 vjeç, të dy të dënuar më parë

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Selman Bitaj, 40 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", (në rolin e organizatorit)
2. R.B, 17 vjeç (kultivues)
3. Poliksen Haxhiraj, 25 vjeç (kultivues)
4. Armand Pashollari, 30 vjeç (kultivues)
5. Jani Ibrahimllari, 49 vjeç (kultivues)
6. Vendim Fejzaj, 27 vjeç (kultivues)
7. Ligor Fejzaj, 56 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike", të cilit iu gjet dhe sekuestrua një armë tip "Shotgun", pa leje (në rolin e rojes)

për veprën "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" (bashkëpunëtor në kultivim). Po të njëjtat burime thanë se gjatë këtij operacioni është ndaluar edhe Enver Pashollari 59

vjeç, kryeplaku i fshatit për akuzën e shpërdorimit të detyrës, pasi dyshohet ka qenë në dijeni dhe nuk ka raportuar për këtë aktivitet kriminal.

"3 djemtë e mi lanë shkollën, jam i detyruar të iki familjarisht jashtë vendit"

SHKODËR

Një vrasje me thikë e ndodhur në prill të këtij viti në fshatin Hot i Ri në Shkodër shkatëroi jetën e dy familjeve; njëra humbi djalin vetëm 27 vjeç, ndërsa familja e autorit ka frikë nga gjakmarrja.

Kristijan Shkambi në festën e Pashkëve goditi për vdekje Kolë Ferosin, dhe ndërsa kanë kaluar 4 muaj në ngujim, djali i axhës i autorit, Anesti Shkambi fajëson kushëririn e tij për vrasjen duke thënë se ishte i dehur kur qëlloi mbi 27-vjeçarin. "Ngjarja ka katër muaj që ka ndodhur dhe ne jemi të ngjuar. Kemi pasur vetëm dy muaj besë kur më vdiq babai dhe për festë. Është një ngjarje shumë e rëndë për familjen tjetër, sepse i ka ikur njeriu i tyre i dashur. E gjithë ngjarja ndodhi pa asnjë arsye. Totalisht fajtor është kushëriri im për vrasjen, pasi ishte në gjendje të dehur dhe e qëlloi me thikë natën e Pashkëve në një kohë që djali që humbi jetën nuk kishte asnjë lloj faj dhe u vra pa asnjë arsye. Jemi koshientë për këtë", tha Anesti Shkambi. Ky u shpreh se ai dhe fisi i tij do të ishin më të kënaqur nëse natën e vrasjes do të ndodhte e kundërta.

GJAKMARRJA


"E dimë dhimbjen e familjes tjetër. Fisi ynë do të ishte shumë më i kënaqur nëse atë natë kushëri jonë të merrte atë që meritonte dhe personi tjetër të shpëronte. Nuk kishte asnjë mundësi, sepse ne do bënim maksimumin që personi që u vra të shpëronte, por tashmë është e pamundur. Familja e dëmtuar na ka pranuar në varrim dhe na ka dhënë dy muaj besë dhe për këtë i falënderojmë. Megjithatë tashmë vijojmë të jemi të ngjuar, sepse është shumë shpejt dhe realisht nuk kemi çfarë t'i kërkojmë familjes tjetër, sepse djali i tyre u vra pa asnjë shkak", u shpreh 52-vjeçari. Familja Shkambi ka marrë një goditje dhe kjo

"Kushëriri na bëri gjëmën, vrau një të ri në fshat dhe na futi në gjak"

Anesti Shkambi: Kemi 4 muaj të ngjuar, besa ka mbaruar dhe jetojmë me frikë



Anesti Shkambi duke folur për "GSH"



Anesti me 3 djemtë

MESAZHI

Anesti Shkambi përcolli një mesazh për rininë. "E kam të vështirë, sepse ne nuk mundëm të edukojmë djalin tonë, pra kushëririn që vrau edhe pse jam përpjekur shumë. Megjithatë u them të rinjve që të qëndrojnë sa më larg armëve, dhunës, sherreve dhe të mundohen t'i zgjidhin problemet me qetësi", tha 52-vjeçari. Gjithashtu, ai dha një mesazh dhe për familjen Ferosi: "Është një ngjarje shumë e rëndë për ta. Zoti i forcoftë. Zoti ia lehtësoftë dhimbjen. Ne jetojmë me dhimbjen e tyre, sepse për ta është vërtetë një tragjedi".

vetëm nga njeriu i tyre dhe jo pala tjetër. "Ne kemi marrë një goditje psikologjike dhe më shumë fëmijët e mi. Djali i vogël sidomos dhe kjo asnjëherë për fajin e familjes tjetër, por për fajin e kushëririt tonë që na çoi në këtë gjendje. Fisi jonë nuk është dëgjuar për të tilla gjëra, por kushëriri na ka sjellë probleme edhe pse i kam folur gjatë gjithë ko-

hës", pohoi Anesti Shkambi, baba i tre djemve. Katër muaj pas asaj ngjarjeje familja Shkambi ka marrë një vendim. Anesti do kërkojë që të largojë jashtë Shqipërisë tre djemtë e tij, Osvaldon 19 vjeç, Fernandon 17 vjeç dhe Alvaron vetëm 12 vjeç. "Familja tjetër e ka shumë më rëndë se ne, sepse kanë djalin të vdekur dhe duke parë këtë situatë ikja nga

Shqipëria e tre djemve të mi mbetet gjëja më e lehtë për ne. Edhe pse unë kam ndërtnuar jetën dhe kam punuar që djemtë t'i kem këtu pranë tashmë është e pamundur. E para është frika, e dyta janë njerëzit që mund të ngacmojnë familjen tjetër dhe ata nuk do ndihen mirë duke qenë në këtu. Ikja për ne është një zgjidhje dhe s'na mbetet opsion tjetër", deklaroi 52-vjeçari.

DRAMA E FAMILJES SHKAMBI

Ëndrrat janë ndërprerë në mes. Djali i madh, Osvaldon ka ndërprerë universitetin "Luigj Gurakuqi" në vitin e parë ku studionte për administrim biznes dhe kohën e kalon mbyllur brenda shtëpisë. Alvaro është vetëm 12 vjeç dhe ai ka një ëndërr të madhe, të bëhet një futbollist i njohur. Është pjesë e akademisë Vllaznia si port-

ier, por tashmë nga frika e gjakmarrjes nuk shkon më në stërvitje. "Djali i dytë edhe pse ka besë, sepse për fëmijët nën 18 vjeç na i kanë lejuar të dalin, ai edhe pak bëhet 18. Djali i vogël po ashtu ka qenë në shkollë dhe në stërvitje me futbollin. Pavarësisht besës për dy djemtë, unë sërish në shenjë respekti ndaj familjes tjetër i kam mbajtur brenda duke mos i lejuar që të dalin. E tashmë që familja tjetër është shumë më e dëmtuar dhe s'ka krahxim. Por edhe unë nuk mund t'i lë djemtë të mbyllur duke mos u shkolluar dhe edukuar kështu që zgjidhje është largimi", u shpreh Anesti Shkambi. Sipas tij, në kushtet kur kushëriri i Anestit e ka varur pas asnjë arsye Kolë Ferosin është e vështirë për të tentuar edhe pajtimin mes dy familjeve.

Bien gurë nga mali, familja angleze: Pamë vdekjen me sy, na ndihmuan banorët

SHKODËR - Udhëtimi i parë i familjes angleze në Shqipëri nuk shkoi siç pritej. Martijn Stolte, bashkëshortja e tij Helene dhe dy fëmijët e tyre 18 dhe 4 vjeç ndihen me shumë fat, pasi i shpëtuan vërshimit të gurëve në rrugën e Komanit. Pas një vizite në Valbonë, familja pokthehej drejt Shkodrës, por në një moment gurë të mëdhenj u shkëputën nga mali dhe ranë mbi makinën ku udhëtonin 4 persona duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre. "Isha në Tropojë në Valbonë, kalova një ditë shumë të bukur. Ishim duke udhëtuar në rrugë dhe kishte shumë reshje shiu. Papritur gurët nisën të binin në makinën tonë. Xhamat u thyen dhe makina u dëmtua. Fëmijët nisën të qajnë, por ne ndaluan menjëherë dhe falë Zotit nuk ndodhi gjë dhe të gjithë jemi shumë mirë. As vetë nuk e di se çfarë kam përjetuar. Jam me fat që dy fëmijët nuk janë dëmtuar edhe pse unë kam disa gërvishje të vogla", tregoi kryefamiljari nga Anglia. Pavarësisht incidentit të rrezikshëm në Shqipëri, Stolte ndan një opinion shumë të mirë për shqiptarë. "Njerëzit e mrekullueshëm të Shqipërisë na ndihmuan shumë. Ata morën gruan time, dy fëmijët dhe i kanë dërguar në hotel dhe tani po çoj edhe makinën nëse mund të rregullohet. Njerëzit janë shumë mikpritës dhe të dashur. Të gjithë kërkonin të na ndihmonin dhe u ndjeme shumë mirë nga kjo, sepse ne ishim në mes të maleve dhe nuk dimë asnjë fjalë shqip", tha Stolte. Ai u shpreh se rruga e Komanit duhet të rikonstruohet menjëherë, ndërsa malet gjatë rrugës duhet të sigurohen për të mos lejuar rënien e gurëve.

APLIKIMET NË MASTER PRANIMET

Voltiza Duro

Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një nga programet e nivelit master në institucionet e arsimit të lartë publik në vend, kanë mundësinë të aplikojnë deri në 12 tetor të këtij viti. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e Këshillit të Ministrave në të cilin theksohet se këto aplikime për master shkencor apo profesional do të kryhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 12 tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 tetor 2018, nënvizohet në udhëzimin e MASR të publikuar në Fletoren Zyrtare. Më tej në këtë të fundit bëhet me dije se brenda datës 22 tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara. Ndërkohë aplikantët do të kenë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve, ku institucionet e arsimit të lartë janë të detyruara të shprehin në vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

REGJISTRIMI

Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 tetor 2018 dhe deri në datën 6.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike. "IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj web, listën emërore të kandidatëve të regjistruar, brenda datës 1 nëntor 2018 për IAL-të publike dhe 8 nëntor 2018 për IAL-të jopublike. Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë të verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas koadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet", thekso-

Dokumentacioni i plotë për konkurrim. Çfarë duhet të dorëzojnë jetimët dhe invalidët

Vendimi, zbardhen datat e aplikimeve për programet e studimit në master

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët



12

TETOR, AFATI I FUNDIT.

"Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 12 tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 tetor 2018", nënvizohet në udhëzimin e MASR.

22

TETOR, LISTAT FITUESE

Brenga datës 22 tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit

htë në udhëzim. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "master profesional" dhe "master i shkencave"/ "master i arteve të bukura", në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, do të realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, sipas kriterëve të përcaktuar paraprakisht.

Kriteret dhe dokumentet Të gjithë ata që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezultoi i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit kanë të drejtë të aplikojnë në një nga programet e studimit në nivel master. Këtë aplikim mund ta kryejnë edhe studentët që janë diplomuar jas-

htë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në rast pranimit kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, brenda muajit dhjetor 2018. Ndërkohë kandidati duhet të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe të bëjë dorëzimin e dokumentacionit përkatës. Respektivisht në udhëzim theksohet se konkurrenca për programet e studimit në master duhet të paraqesë diplomën ose fotokopjen e saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, aplikanti duhet të dorëzojë edhe: Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopjen e tyre të njësuar me origjinalin; formularin e aplikimit; fo-

tokopjen e mjetit të identifikimit; si dhe dy fotografi personale. Ndërkohë kandidatët e kategorive të veçanta duhet të dorëzojnë edhe këtë dokumentacion shtesë: fotokopjen e noterizuar të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Aktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Sakaq, kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ndërsa aplikanti nga komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian. "Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL-në publike

dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer: QSHA-ja pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimit. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respek-

tive dhe IAL-së, si dhe në medianë dhe shkruar dhe elektronikë", theksohet në vendim. Brenda datës 19 nëntor 2018 institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, listën e studentëve të regjistruar, me qëllim pajisjen me numër matrikullim. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënie e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

DOKUMENTACIONI

◆ Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

◆ Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësitë përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimit në shkollat e larta publike", të ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësitë përkatëse arsimore vendore DAR/ZA). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësitë përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

◆ Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzim);

◆ Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

◆ Dy fotografi personale.

MEKA
ADHURIM I GJITHE NJERZIMIT

Pelegrinazhi, Kurbanit dhe Haxhinjtë e parë shqiptarë në Mekë



Ferdinand Samarxhi
Mjeshtrë i madh

Këto ditë nga e gjithë bota Islame janë nisur dhe gjenden në vendet e shenjtë të Arabisë Saudite si në Mekë, Medinë, Arafat etj, miliona e miliona njerëz. Më 18 qershor të vitit 1991, ku agji i demokracisë kishte filluar të shndrrinte në tokën e djegur të shqiptarëve për liri dhe besim, do të niseshin për në Mekë e shenjtëruar dhe adhuruar, 100 shqiptarë e parë të prirë nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë Hixrisë e Tij e Lartë Haxhi Hafis Sabri Koçi, për të kryer adhurimet e shenjtë të Haxhillëkut të parë i shenjtë që do të linte vlagë në historinë e ngjalljes së besimit për kohën dhe shqiptarët. Në këto vende të shenjtë, që në fillimet e para të demokracisë shqiptarët morën rrugëtimin e tyre për të kryer Haxhillëkun, një nga pesë obligimet e shenjtë që duhet të kryejë çdo besimtar Islam. Qyteti mikpritës i tyre, si zakonisht, është Xheda. Në këtë rrugëtim shpirtëror pelegrinët priten si mysafir në qytetin e Mekës, ku nisi zanafilla e jetës që përkohet me historinë udhëtimit të Hazretit Ibrahim me familjen e tij, në një luginë të pa pjellshme, ku gjendet sot Meka, qyteti më i shenjtë i botës. Në këtë luginë të pa pjellshme, Hazret Ibrahimit dërgoi gruan e tij të dytë Haxhirenë me djalin Ismailin, për shkak të grindjes së saj me gruan e parë Sarën. Në këtë shtëpi të zotit Hazret Ibrahimit u lut zotit që zemrat e njerëzve të anonin zotë mirat dhe të largoheshin nga të këqijat. Këtu ai do të lutej Zotit që t'i jepte udhë veç të mirave. ...dhe Zoti e dëgjoi atë. Zoti lumturroi Haxhirenë, Ismailin dhe vetë jetën, kur Haxhireja zbuloi Bunarin, Zem Zem, burim që shuajti etjen djalit, Haxhiresë dhe të miliona e miliona njerëzve në këtë vend dhe u dha fat atyre në jetë. Në këtë vend Hazret Ibrahim vuri fars

fizitën e tij gjithë njerëzimit, ku të gjithë njerëzit në Qabe kërkojnë faljen e mëkateve, largimin e të këqijave, shpëtimin e tyre dhe këthimin e tyre fatlumtur në jetë. Rreth Qabesë, Gurit të Shenjtë njerëzit rrotullohen shtatë herë dhe drejtohen nga bregu Safa Merve për të bërë Sajin domethënës, vrapimin shtatë herë pesëqind metra, që e bëri nëna e profet Ismailit, Haxhireja për të zbuluar burimin e ujit, që të shpëtonte të birin ku pasi u kthye gjeti të këmbët e të birin uji që buronte dhe kllithi Zem Zem. Mbas njëzet e pesë kilometrave, vendi që do t'u shfaqet pelqinëve është Arafati, vendi ku u takua njeriu i parë Ademi me Havanë dhe filluan krijimin e jetës së re të parë në tokë. Qëndrimi në Arafat ka të bëjë me pastrimin e mëkateve të çdo njeriu, të çdo krijese njerëzore dhe të këthet në jetë ashtu siç ka lindur nga nëna si një fëmijë i pastër, si më i pastri i gjithë krijesave, pa mëkate e pa gynahe. Durimi ndaj vështirësive që të gjithë kalojnë në këtë vend është si një rikujtim i jetës së Pejgamberit Ibrahim që zoti t'u mësojë durimin të gjithëve. Të gjitha këto luteje dhe adhurime ndaj krijesit të gjithësisë Allahut, shoqërohen me vazhdimisht kuranore. Këtu të gjithë kujtojnë se lindi jeta, lindi njeriu i pastër sic e lindi dhe e kërkoi zoti që ai të jetë në të gjithë jetën. Të gjithë drejtohen nga kodra e Xhubile Rahme që të këthehen në njerëz të tillë. Në Muzdilibë dhe Mina të gjithë haxhinjtë, pelegrinët mblehin gurë në vendin ku i mblodhi dhe Hazret Pejgamberi, të premtën duke u gdhirë e shtuna e Bajramit,



Meka-Adhurim për gjithë njerëzimin

për të vrrarë shejtanin në vendin e quajtur Xhemra Tul Akabeh ku që të gjithë gjuajnë tre herë nga shtatë gurë duke menduar se tashmë ata e kanë vrrarë përfundimisht shejtanin (djallin) dhe ashtu të pastër siç kanë lindur nga barku i nënës heqin robën e Erhamit dhe veshin rrobat e mëparshme. Të pastër dhe të gëzuar Haxhinjtë, pelegrinët, vazhdojnë rrugën e tyre të pelegrinazhit në qytetin e Medinës, në qytetin ku gjeti vend strehim Pejgamberi, ku zbuloi aktivitetin më të madh dhe u varros. Medina është vendi i shenjtë i Pejgamberëve, i Mbretërve, qyteti i xhamisë së shenjtë të Pejgamberit. Këtu të pasurit kanë si ndjenjë dhe obligim që të ndërtojnë Faltore. Këtu ka shumë të pasur dhe në Medinë ka shumë Xhami. Në këtë qytet u zhvillua dhe lufta e dytë e profetit Muhamet me kundërshtarët e tij. Në vitin 622 profeti u shpërngul nga Meka në Medinë. Këtu gjendet edhe xhamia e dy Kibleve ku profeti u fal dhe u lut pas tetë muajve të Hixhretit. Në këtë qytet ku shlyen miliona e miliona



kurane që shpërndahen anekënd botës gjendet shtypshkronja më e hershme e njerëzimit dhe maketi i kuranit, ku botimi i tij ka kaluar nga shtypi me dorë deri të më i sofistikuarit (dixhitalizuar) në kohët e sotme. Në këtë qytet, ashtu si Meka, ndodhet edhe mrekullia tjetër e shenjtërisë, xhamia e Pejgamberit, e profetit që zbriti si mëshirë e gjithë botëve për mbarë njerëzimin e profetit që përfitoi si askush zemrat dhe shpirtat e gjithë njerëzimit siç e ka quajtur Bernard Shou, lavdia më e madhe që udhëhoqi njerëzimin në dritën e vërtetë. Njeriu që shpalli fenë e zotit, jo më si shumë profetë të tjerë,

vetëm popujve të tyre, por gjithë botës siç thotë Napoleon Bonaparti: njeriu që triumfimi dhe fitoren e kurorëzoi me mëshirë dhe falje. Njeriu që u bë udhëheqës i vërtetë shpirtëror, prijës e sundimtar pa përdorur forcë si logjikë antinjerëzore. Njeriu që sundoi në sajë të besueshmërisë dhe besimit. Njeriu që krijoi një religjion të cilën e pranuan miliona e miliona njerëz duke e shndërruar atë në një të universale. Pelegrinët mësojnë të gjithë në këtë qytet për lajmëtarin dhe të dërguarin e fundit të Allahut, për të gjithë kohërat e për të gjithë popujt të cilët e pranuan besimin e tij. Drita që erdhi në shkretëtirë dhe ndriçoj mbarë rruzullin tokësor ku zoti u betua "Komunikoni me atë që tu zbriti prej zotit tënd". Të gjithë pelegrinët mësojnë në këtë qytet, pranë kësaj faltoreje, se profeti Muhamet megjithëse ishte më i shenjtë, më i dashuri, më i zgjedhuri i Allahut gjithnjë do të thoshte: "Midis jush unë jam ai që njoh Allahin e madhërisëm më së miri, dhe i frikësohem atij më së shumti". Në këtë qytet ata mësojnë jetën e këtij profeti, filozofinë e tij që në vend të urrejtjes mëkoj dashuri përtej dashurisë, përtej dhimbjeve, përtej vuajtjeve. Ai që ndjen armiqësi ndaj Ehli Bejtit tim është Mynafik. Paqa, dashuria dhe drita duhet të udhëheqin çdo njeri që beson, çdo njeri që jeton. Xhamia e Pejgamberit, historia e saj sa më shumë e lexon, më shumë kupton dritën e besimit dhe njerëzimi ka udhëtuar në vite bashkë me profetin. Xhamia edhe pse daton në kohëra të hershme sipërfaqja e saj me 82.000 m2 (tëtdhjetë e dy mijë metër katrorë) vazhdon e rritet në




përmasa më të mëdha akoma dhe në ditët e sotme. Dhjetë minare 103 m (një qind e tre metër) të larta ku hëna e çdo minareje është e veshur me 4.5 tonë Ar secila e qarkonit duke i dhënë madhësi hyjnore. Pelegrinët mësojnë se gurin themeltar e ka vënë mbreti i Arabisë Saudite Feh Abdulah Aziz. Sipërfaqja e saj nga lartë është e mbuluar me 27 kupola që peshojnë nga 80 ton secila të cilat hapen dhe mbyllen sipas kohës që falja kurrë dhe asnjëherë të mos prishet pasi falja në këtë xhami është shenjtëri.

KURBANIT... HISTORIA E TIJ

Njeriu si qenia më gjeniale e universi i pajisur me një ndërjegje të lartë ndryshe nga krijesat e tjera që nga zanafilla e jetës gjithmonë ka ndërjerë dhe ka pasur nevojë për t'i ur drejtuar dikujt. Në fillimet e para ata ju drejtoheshin dhe kërkonin ndihmë gurëve, pemëve, fenomeneve të natyrës deri kur një ditë i larguan dhe arritën të besojnë vetëm krijesit, zotit, në religjion të ndryshme sipas pikëpamjes së tyre. Gjithë historia e jetës së njeriut, nevojat e tij janë manifestuar në forma dhe mënyra të ndryshme dhe duke qenë të besuar nën një religjion sipas udhëzimeve të tyre hyjnore. Në këto forma dhe këto mënyra të komunikimit midis zotit dhe njeriut është dhe flajimi, sakrificat që në terminologjinë fetare quhet "Kurban". Këto forma të ndërlydhura ndërmet Zotit dhe njeriut kanë në kohëra "Simpatinë" e krijesit dhe meritojnë dhuntitë e tij. Kjo traditë është rrenjosur thellë të popujt e vjetër asirian, persian, fenikas, egjiptian, grekë, arab, sllavë. Të dhënat dhe hulumtimet e ndryshme tregojnë se nga rrafshi i feve komparative kulturat dhe qytetërimet e vjetra si adhuruesit e diellit, të hënës, të yjeve dhe objekteve dhe fenomeneve të ngjashme e njohin institucionin e flajimit, kurbanit. Nëpërmjet sakrificimit të vetvetes ose formave të ndryshme të tjera duke kërkuar të fitojnë simpatinë e krijesit ata kanë rrugëtuar gjatë prej shekujsh në histori duke rrelivuar me jetën. Flajimi është ritual me të cilin njerëzit kanë kërkuar dhe kërkojnë që vullneti i zotave dhe genieve mbinaturore tu dalë në ndihmë nevojave, përmëshjes së tyre dhe dëshirave. Shprehje tipike të besëtytnisë kanë pasur forma të tmerrshme jo humane: flajimi i njerëzve në



Hafis Sabri Koçi me haxhijtë e parë shqiptarë në Mekë





Transmetim i drejtpërdrejtë i RTSH të festës së Kurban Bajramit. Kryetari i KMSH, hirsësia e tij e naltë Haxhi Skënder Bruçaj uron Shqiptarët: Gezuar festën



Odeoni i Kryegjyshitës Botërore Bektashjane, Pamje të filmuara nga transmetimi i RTSH



Xhamia e re e Namazgjasë amfiteatri i shenjtë i besimit Islam

religionet e vjetra dhe primitive.

Latinët e vjetër këtë formë të flijimit e shprehin më thënien e njohur "do ut des" "jap që të më japësh mua". Ky lloj institucioni "jap që të më japësh mua" janë të panjohur në besimin Islam sepse raportet Krijues/Krijesë do të vendoseshin në vijë komerciale, korruptive, interesi etj. Duke pasur parasysh gjithmonë qenien jo të përkryer, jo të arrirë të zhvillimit dhe intelektualit të njeriut, zoti i gjithëpushtetshëm, i gjithëfuqishëm ka dërguar gjatë historisë, të dërguar të tij, profetë të zgjedhur të tij që ti ndriçojnë ata në rrugën e besimit. Duke humanizuar sakrificën, duke fshikëruar dhe lartësuar atë nga motivet primitive, supersticioze, egoiste, ekspluzive e idhujtare në motivet fetare në altruiste, humane e sociale.

Nëse kurbanin e redukojmë në aspektin juridik dhe të teknikës së prerjes së kurbanit ne me këtë mendim dhe veprim kemi varfëruar këtë institucion dhe u japim të drejtë atyre që kurbanin e trajtojnë njëanshëm.

DIMENSIONI RELIGJIOS I KURBANIT.

Kurbanin si komponent qenësor i besimit Islam është në funksion të tëhëditit- konfirmimit të Një, të vetmit Zot. La ilahë illallah, Muhammedun resulull-llah. Kontakti që vendoset me zotin e madhërishtëm është i drejtpërdrejtë dhe pa kurrfarë elementësh politeizmi, idhujtarie (shirk), Në besim flijimi është akti i gatishmërisë së njeriut, një akt i sinjërimit të njeriut për të flijuar gjënë më të shtrënjtë, më të dashur që posedojmë në emër të krijuesit madhështor, por jo për t'i bërë qef krijuesit, jo për t'u serviluar Atij, por për se ndërtimin e porosive nga fjalët e krijuesit në jetë për vetë mirëqenien tonë individuale dhe shoqërore ... Allahu vërtet nuk ka nevojë për askë në tërë botën "El-Ankebut". Thelbin, esencën e qëllimit të kurbanit e shprehon vetë Krijuesi në Ajetin vijues: "Tek Allahu nuk arin as mishi (i kurbanit), as gjaku i tyre, por tek Ai arin Tak Vallëku (devotshmëria jua)." El- Haxhah, 37. Kjo kupton se kafsha e flijuar është vetëm ndërrim simbolik me atë që njeriu duhet flijuar. Për këtë mjafton të kujtojmë shembullin e Hazretit Ibrahim a.s. i cili si baba dërgoi për të flijuar të birin e tij Ismailin në turën e druve dhe shembulli i Ismailit, i cili pranonte të flij-

jojë gjënë më të shenjtë vetveten. Rasti i Ibrahimit a.s. dhe Ismailit a.s. është i papërsërtshëm në historinë njerëzore dhe si i tillë duhet të ndikojë insirativisht të njerëzit, besimtarët në këtë shekull dhe epokë të globalizmit kundërshtish dhe antagonizmesh, humbje vlerash dhe egoizmin, në kohën kur njeriu po humb gjera me vlerë të dinjitetit dhe vlerave njerëzore.

KURBAN... MORALI I TIJ

Kurbanin, si synim parësor, është formimi i njeriut dhe i vetdijes dhe karakterit të tij. Kurban është shembulli më tipik i formimit të njeriut: vet akti i kurbanit tregon gatishmërinë kulmore për dashurinë sublime ndaj zotit dhe për zbatimin praktik të urdrave të tij. Akti i prerjes së kurbanit, në shikim të parë është i vrashdhe, primitiv e mizor, zhvillon të besimtarit vetdije, por edhe kritere në bazë të së cilave ai do t'i valorizojë kategoritë etike dhe do t'i afirmojë vlerat pozitive. Ndërgjegjja, solidariteti, altruizmi dhe vetdija se flijimi i një pjese të krijesave të gjalla të tjera të gjithësisë, në rastin e kurbanit, kafshët në dobi të pjesës tjetër është çelësi i shpëtitimit, të njeriut, shoqërisë apo bashkësisë nga shkatërrimi i saj dhe shkalla më e lartë që synon kurani.

DIMENSIONI SOCIAL I KURBANIT

Kurbanin në aspektin social është qëllim parësor i barazisë sociale ndërbarazi. Gëzimi që përjeton i pasuri duhet ti buzëgëshë edhe të varfrit, por edhe kategorisë që për shkak të ndërrimit, modestisë, apo ngurrimit nuk e shprehin dhe nuk e dëshmojnë varfërinë e tyre. Kurbanin është akt, është veprim që besimtari e bën në emër të krijuesit dhe gatishmëri për realizimin e parimeve hyjnore. Historia e



njeh kurbanin që nga fillimet e para, Ademi a.s. e deri në ditët tona. Simboli i kurbanit, gjithashtu, ndikon që të unifikohet dimensionin shoqëror dhe religjioz, e të gjitha këto në formën e Maksimës së Thëhdit: "Nuk ka Hyjni tjetër përveç Zotit".

KURBAN...HISTORIA E TIJ NË SHQIPËRI

Diku në lashtësi midis Gjyrokastërës dhe Sarandës figurojnë dy qytete: Helanon dhe Helakranon. Fjalë ku në rrënjë e tyre gjenden Hellopia, Helloi, Selloi, "me rrënjën Hell" duke farkëtuar kështu që kurbanit bëhej nga njerëzit si flijim për perënditë. Të dhënat historike në vendin tonë flasin për kurbanin që bëhesh për



Kryegjyshi Botëror H.Dede Edmond Brahimag duke bërë kurban për mirësi për shqiptarët

është përcjellë kohë pas kohe e brez pas brezi dhe Tomori i sotëm (Dodona pellazgjike) është vendi, ku vijmë nga e gjithë bota, siç vijnë dikur të gjithë nga të gjitha viset e Ilirisë së Veriut, keltët, galët, grekët, egjiptianët, asirianët etj. dhe bënin kurban dhe flijime për perëndinë, në tempullin e lashtë, të parin në botë në tokën e Molosëve të Dodonës së Sipërme, Thesprot. Ky tempull sot është Kanotaf i Abas Aliut që, siç thotë Naim Frashëri: "... çështje ai që shkollon, me dy tre foshnja në duar, që lëshon verin, është Abas Aliu". Ky pelegrinazh i ardhë nga historia që ka rrezuar shenjtëri për gjithë botën e kohëve gjithnjë e më shumë po merr përmasa dhe konture botërore si dikur i organizuar nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Kryegjyshi Botëror Shënjtëri e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimag. Pelegrinazhi i parë i shqiptarëve në Mekë.

18 qershor 1991. Pas një kohe të gjatë, pas një periudhe të tërë moniste antifetare, 180 shqiptarë do të shkonin për herë të parë në vendin e shenjtë, "Për Allah në vendin e Allahut" për të kryer një nga 5 obligimet e shenja të zotit, Haxhillekun. Pas kaq kureshtesh shërbesa fetare kërkoi që të gjithë Haxhinjtë Shqiptarë të veshin rrobën e shenjtë të Erhamit. Çdo besimtar duhet të jetë i zhveshur nga petkat të cilat mund të jenë të ndotura me ndonjë mëkat. Hafiz Sabri Koçi, Kryetar i delegacionit, Kryetar i Bashkësisë Islame, dhe Sheiku me origjinë shqiptare Ismet Kazim përgjegjës dhe organizator i delegacionit tonë në Saudi u gjetën të rrethuar nga gazetarët e televizioneve, agjencive të ndryshme të lajmeve. Si u bë e mundur që në Shqipëri të lejohej feja, besimi. Delegacioni ynë do të bëhej epigjendra e 116 delegacioneve të vendeve të ndryshme të botës. 180 Haxhinjtë shqiptarë do të ishin në të privilegjuarit mes 7 milion Haxhinjve të ardhur nga e gjithë bota.

Meka, qyteti ku të gjithë Haxhinjtë e pritin dhe e adhurojnë. Kishim mbërritur më në fund të gjithë Haxhinjtë shqiptarë të qytetit e adhuroar të Mekës për të cilin na ishin krijuar në mendje kaq legjenda dhe histori për hazretë, pejgamber, mbretë, kalif, histori të qindra e miliona njerëzve që vijnë këtu në kohë të hershme në këmbë me deve që udhëtonin me kohë të tëra për të ardhur të kjo shtëpi e zotit e shenjtë si atëherë edhe sot. Gazetat botonin lajme për mbërritjen e delegacionit të Haxhinjve shqiptarë. Në qytet Haxhinjtë Shqiptarë do të priteshin nga ministri i shtetit i Haxhi sheiku Abduluahab Abduluea si të ftuar miq të mbretit. Ministri i Haxhit vlerësoi zhvillimet e reja që kishin ndodhur në Shqipëri dhe i çmoi ato si procese që çojnë në zhvillimin e demokracisë dhe zhvillimin e vendit.

Pas shumë çasteve të shumëllojshme kishte ardhur kohe për të shkruar në Qabe? Po pse të jetë vallë kaq e adhuroar Qabeja. Historia e saj nis me udhëtimin

e Hazret Ibrahimit me familjen e tij në një luginë të pa pjellshme ku gjendet sot Meka, në të cilin ai dërgoi atje gruan e dytë Haxhiren për shkak të grindjes të saj me gruan e parë Sara. Në këtë shtëpi të shenjtë ai ju lut zotit që zemrat e njerëzve të anonin nga të mirat dhe të largoheshin nga të këqijat. ...Të gjithë haxhinjtë u drejtuan nga bregu Sfaee Merve për të bërë sajin domethënës, vrapimin 5 herë 500 metër që bëri nëna e profetit Ismail Haxhireja për të zbuluar burimin e ujit që të shpëton të të birin. Që kur Haxhireja dhe Hazreti Ismail shuan etjen nga burimi që gjetën në këmbët e tij duke klithur Zem Zem, u bënë me fat dhe ishim dhe haxhinjtë shqiptarë tashmë njerëz fatlumtur dhe të gëzuar në këtë jehonë që kishte nisur në mes tyre, të besimtarëve tanë. 25 km larg haxhinjtë shqiptarë do të udhëtonin drejt një vendi tjetër të shenjtë Arafatit. Qëndrimi këtu në Arafat, Ibadetet që kryen kanë të bëjnë me pastrimet e mëkateve dhe ta bëjnë atë si atë ditë që e ka lindur e ëma të pastër. Në këtë vend haxhinjtë shqiptarë do të mësonin durim ndaj vështirësive para zotit, do kuptonin profet Ibrahimin dhe do të pastronin të gjithë mëkatet në kodrën e shenjtë Xhebelu'r rrahme. Në Muzilifhe dhe Mina haxhinjtë shqiptarë do të mblidhnin gurët e shenjtë në vendin ku i mblodhi hazret pejgamberi të premtën duke u ghirë e shtuna e bajramit për të vrrarë shejtanimin dhe për të larguar djallin njëherë e përgjithmonë. Në obligim haxhinjtë shqiptarë do të vizitonin qytetin e Medinës, qytetin e xhamisë së pejgamberit ku këtu do të shikonin xhaminë Kibletein, shtypshkronjën e kuraniut me maketin e saj sa të lashtë aq dhe historik. Do të mësonin se këtu u vendos pejgamberi në vitin 622 kur u shpërngul nga Meka. Pas 18 muajsh, hixheretit për herë të parë nga kjo xhami preferi u drejtua Allahu nga Qabeja dhe nga ai moment myslimanët u obliguan të gjithë nga të drejtimit, sepse deri në atë kohë drejtoreshin nga Jeruzalemi i sotëm.

Të gjithë haxhinjtë pas një muaji qëndrimi në këto vende të shenja të larguan si njerëz fatlumë, si haxhi, si njerëz të mirë e me fat, që ndoshta do të binin, edhe për njerëzit në Shqipëri. Festa e kurban bajramit sivjet vjen në Shqipëri si një gëzim dhe festë madhështore që të gjithë besimtarët do të falin namazin e bajramit me një përkushtim dhe dashuri të madhe ndaj Allahu. Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Hirsësia e Tij e Naltë Haxhi Skënder Bruçaj duke punuar me zell, përkushtim dhe vizion bashkëkohor për ndërrimin më tej të besimtarëve në rrugën e tyre të besimit do të bëjë që ata të falen vitin e ardhshëm, në faltoren e re, në tempullin e bukur, amfiteatër madhështor, hyjnor të besimit Islam. Siç na informon drejtori i kulturës z.Agron Hoxha namazi i bajramit do të zhvillohet në sheshin "Skënderbej". Si gjithnjë, tradicionalisht festa do të përcillet në të gjithë vatrat shqiptare të kombit tonë, kudo në gjithë botën, nga valët ekskluzive të RTSH-se.

PERKUJTIMI

Kur shtrati ishte dhomë, jeta që niste nga kamioni i deportimeve

Fatmira Nikolli

Më 23 gusht, në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare organizohet Dita Muze në Kampin e Tepelenës, nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Bashkia e Tepelenës, Harabel dhe MEMO, me të mbijetuar, institucione e shoqëri civile aktive, me mbështetjen e PNUD Shqipëri, qeverisë së Italisë dhe ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.


Aktivitetet fillojnë në orën 12.00 në Pallatin e Kulturës, Tepelenë, me ekspozitë me materiale arkivore dhe simpozium shkencor mbi punën e detyruar në diktaturë, duke paraqitur edhe ecurinë e punës për projektin e Muzeut Kombëtar të Kampeve të Punës së Detyruar.

Vijojnë në orën 18.00 në Kampin e Tepelenës, me nderimin e të mbijetuarve nga Presidenti i Republikës, në shenjë të triumfit të dinjitetit njerëzor dhe me projektin artistike-sociale të MEMO e artistëve të tjerë, në bashkëpunim me Harabel.

Po atë ditë zhvillohet aktiviteti "N'dritë" në nderim të të internuarve të Kampit të Tepelenës 1949-1953, organizuar nga AIDSSH dhe Harabel. MEMO do të japë kontributin e saj me "Sikur mama", dy km me kamionin e deportimeve; me "Dhomën shtrat", rindërtim i situatës së kampit, bazuar në vizatimet e Lek Pervizit dhe "I përkasim njëri-tjetrit", video në vetë të parë, bazuar në histori të vërteta.

"SHTRATI DHOMË"
Kamioni do të ndalet pranë ish-fjetores së kampit, ku një punëtor do të jetë duke ndërtaur një "shtrat dhomë", sipas vizatimeve të Lek Pervizit dhe ndërkohë, të mbijetuarit e pranishëm mund të ndajnë kujtimet e tyre apo të tregojnë se si e mbajnë mend atë vend, duke i dhënë orientime punëtorit. Në kapanonet e mbi-jetesës dhe në jo pak raste, të vdekjes, ishin të detyruar të jetonin rreth 700 persona në të njëjtën hapësirë.

Cdo familje, - kishte edhe me nga dhjetë vetë, - kishte në dispozicion katër metra katrorë sipërfaqe dërrase në të, ku të jetonte dhe të flinte. Në jo pak raste, kjo do të thoshte rreth 30-40 cm hapësirë për person.



Përkujtohen në Kampin e Tepelenës të dënuarit e sistemit totalitar

Transformimi i ardhshëm i kampit në Muze Kombëtar të Kujtesës parashikon rindërtimin e njëjës prej kazermeve, sipas kushteve të jetesës së të internuarve gjatë 1949-1953, në kampin me tela me gjemba.

Me rënien e errësirës, kamioni do të shndërrohet në një hapësirë ku do të mund të shihen videot e nismës "I përkasim njëri-tjetrit", një pjesë e të cilave janë bazuar në histori të ndodhura në kamp. Kamioni do të transformohet në kinema të hapur.

"SIKUR MAMA"...
Gratë dhe fëmijët janë dërguar në kampin e Tepelenës pa pasur mundësi të merrnin gjë me vete, veç rrobave të trupit. Disa prej tyre kanë vdekur rrugës, prej urisë dhe kushteve të motit.

Kjo performancë artistike do të jetë një ndërveprim në distancë kohe me rrugëtimin e gjatë të shumë grave e fëmijëve të dënuar në kampin e Tepelenës. Një kamion i epokës (nga të pakët ende të mbetur) do t'i presë të ftuarit dy kilometra përpara mbërritjes në kamp. Staffi i MEMO-s do t'i orien-

tojë të ftuarit të hipin në kamion.

Përgjatë rrugës për në kamp do të ketë zhvillime të tjera që mund t'i përfjeroni në vetë të parë...

"I PËRKASIM NJËRI-TJETRIT"

Me drejtor ekzekutiv Gjon Ra-

dovanin dhe bashkëpunimin e Ema Andreas si autore e drejtoreshë artistike, Agron Tufës si humlutes e shkrimtar, Ervin Kotori si regjisor, Gjergji Panos si montazh, Ema Ndojës si bashkëpunëtoreshë dhe Elvana Zaimit si përkythuese, qasja artistike-sociale është një ide e Ema Andreas, autore e projektit në fazën e parë të tij. Historitë e vërteta të vetëm pak viteve më parë, pas të cilave janë fatet e shumëkujt, - vëllait, motrës, fëmijës, të kole-



gut, të të afërme tanë, të njohurve apo të panjohurve e sot duket sikur nuk kanë ndodhur kurrë, - janë përzgjedhur dhe sjellë në vetë të parë nga shkrimtari Agron Tufa. Ideja, koordinimi, përkthimi dhe realizimi artistik e teknik i çdo videoje janë bërë të mundura nga puna kolosale dhe përkushtimi i të gjithë grupit të mësipërm. "I përkasim njëri-tjetrit" ka bërë bashkë përvojat të fushave të ndryshme për të iniciuar një projekt shumëdimensional, që në thelb mbështet marrëdhënien me të vërtetën dhe mbështetjen të bashkëpunimit me të gjithë ata që e ndiejnë këtë përgjegjësi shoqërore ndaj së shkuarës dhe së tashmës.

Historitë e vërteta, të trajtuara artistikisht dhe të interpretuara nga personazhe publikë e njerëz të zakonshëm, mund të gjenden në faqet zyrtare ose dokumentet që zotërojnë institucionet shtetërore të kujtesës, në publikime, libra apo portale online dhe kanë arritur deri te në nëpërmjet dëshmi, kujtimeve dhe vullnetit për të treguar të vërtetën e të mbijetuarve të regjimit komunist. Zgjedhja për të rrefyer monologët, - duke dashur që historitë mbi jetët e të mbijetuarve ose atyre që nuk ia dolën të shkojnë te të gjithë dhe t'i flasin me zë të lartë shoqërisë së sotme shqiptare, - është e lirë dhe shpreh qëndrimin individual të gjithkujt që ka vendosur të jetë një zë për të pazëshmit.

PROGRAMI I DITËS MUZE / MEMORIAL TEPELENË

Në Pallatin e Kulturës në Tepelenë Dita Muze nis me ekspozitë me materiale arkivore të AIDSSH mbi persekutimin komunist në zonën e Tepelenës që ndiqet nga nga simpozium shkencor mbi kuadrin historik dhe juridik të punës së detyruar, në përgatitje të konferencës mbi kampet e punës së detyruar, të zbatuar nga AIDSSH, me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë ku referojnë Prof. Dr. Beqir Meta, Ermal Frashëri dhe Çelo Hoxha. Prezantimin e kurisë së projektit të Muzeut Kombëtar të Kampeve të Punës së Detyruar-të Memorialit e bën Gjon Radovani, arkitekt

dhe Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH bashkë me Aleksandër Totin, shef kabinetit i Bashkisë Tepelenë e Johan Ndisin, Ambasador i Suedisë në Shqipëri.

Te ish-Kampi i Tepelenës në orën 18.00 bëhet pritja e Presidentit të Republikës, Ilir Meta e shoqërimi në mjediset e ish-Kampit dhe ekspozitën me materiale e dëshmi, drejtuar nga Simon Mirakaj dhe të mbijetuar të tjerë. Më pas vijohet me ceremoninë e nderimit të të mbijetuarve të vuajtjes, ku të pranishëm janë Tërmet Peçi, Kryetar i Bashkisë Tepelenë; Simon Mirakaj, Anëtar i AIDSSH, Brian J. Èilliams, Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësues i Përhershëm i PNUD në Shqipëri, ministria

Mirela Kumbaro, Bilal Kola, Drejtor i Institutit të të Përndjekurve Politikë, Nebil Çika, Kryetar i Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë, Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër dhe Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH. Presidenti Meta në praninë e të ftuarve u jep titullin për "Merita të veçanta civile" të mbijetuarve, në shenjë të triumfit të dinjitetit njerëzor dhe në emër të tyre do të flasë Lek Pervizi, ish-i burgosur politik. Në vijim mbahet aktiviteti "N'dritë" me disa vepra si edhe koncerti me grupet ASGJË SIKUR DIELLI dhe 3 MUSKETIERËT, si triumfi i jetës dhe dinjitetit

SI TA NXIRRNË MË THJESHT TEPRICËN E UJIT NGA VESHËT

SUMMER


pages

SUPLEMENT I GAZETË SHQIPTARË

E martë 21 Gusht 2018



**VALBONA SELIMLLARI
NË JUG ME VAJZËN**



**Roza Lati ngre
temperaturat**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Çfarë i bëri bashkë Stresin dhe Metën? Reperi lavde për presidentin
- "Ia doli", Saimir Tahiri i mëson të birit të zhytet në ujë
- Presidenti rus Putin bën kavalierin në dasmën e ministres austriake
- Njihuni me Edi Ramën e Universitetit të Oksfordit



Detaje nga festa e "Baby shower"-it të këngëtares

ADELINA TAHIRI
**Bashkëshorti miliarder i
dhuron unazë me diamant**

Ja të ftuarit VIP të çiftit

Detaje nga festa e "Baby shower"-it të këngëtares

Bashkëshorti miliarder i dhuron unazë me diamant

Ja të ftuarit VIP të çiftit

Egla Xhemali

Adelina Tahiri është në pritje të fëmijës së parë. Këngëtarja u shfaq mjaft e lumtur në festën e mikpritjes së të birit. Ajo që ra në sy nga "Baby shower" i djalit që pritet të vij shumë shpejt në jetë ishte kodi i veshjes dhe dhuratat e shumta që ishin bërë për foshnjën. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të veshur me të bardha. Këngëtarja dukej për mrekulli në këtë festë, veshur me fustan të bardhë, ndërsa detajet, të cilat i dhanë ngjyrë kësaj feste ishin të rregulluara edhe me



Për një kohë jo të shkurtër jeta luksoze, veshjet, pushimet, blerjet në shifra marramendëse e bënë Adelina Tahirin objekt të diskutimit, por edhe të misterit. Për një periudhë relativisht të gjatë, ajo ia doli ta fshehtë nga publiku partnerin e saj, maqedonasin Serjoza Markov.

pos familjarëve, që zinin vendet kryesore në festë qenë disa nga fytyrat e njohura publike si këngëtares Big Mama dhe Fjolla Morina, prezantuesi Avni Qahili etj. Artistët ndanë foto dhe video të ndryshme, në të cilat shihej se po argëtoheshin pafund në festën e Jonit. E veçanta e mbrëmjes që rrëmbeu vëmendjen e të gjithëve ishte



dhurata që i shoqi i bëri Adelina. Unaza diamant që bukuroshja mbante në duar

ka një çmim tejet të lartë. Po surprizat nuk ndaluan me kaq. Këtë herë më së

shumti për vogëlushin. Këngëtarja, dje vendosi të ndajë me fansat e saj, se cilat ishin dhuratat që i erdhën asaj nga festa. Kështu një video të postuar në rrjetin social "Instagram", duke xhiruar dhomën e bebes, Adelina sjell pamje ku shihet dhoma luksoze e stërm-bushur me dhurata të ndryshme, që së shpejti do jetë e djalit. Kuti të paketuara, lule të shumta, majmunë prej lodre, ishin disa nga surprizat që i kishin bërë familjarët dhe kolegët për Jonin. Për një kohë jo të shkurtër jeta luksoze, veshjet, pushimet, blerjet në shifra marramendëse e bënë Adelina Tahirin objekt të diskutimit, por edhe të misterit. Për një periudhë relativisht të gjatë, ajo ia doli ta fshehtë nga publiku partnerin e saj, maqedonasin Serjoza Markov. Por, një varg zhvillimesh që ndodhën shpejt, e zbuluan misterin e këngëtares. Çifti po jeton këtë pritje të ëmbël teksa duken shumë të lumtur kraher njëri-tjetrit. Gjatë kësaj periudhe të shtatzënisë këngëtarja 26 vjeçare ka publikuar edhe një set të mahnitshëm fotografik.

ngjyrën blu, meqë fëmija do të jetë djalë. Bukuroshja ka zbuluar edhe emrin e foshnjës që po pret, e që do quhet Jon. Bëri bujë organizimi luksoz që ishte menduar deri në detajet më të vogla,

mysafirët VIP të ftuar dhe çdo gjë tjetër mori vëmendje të madhe. Pa u diskutuar nuk kanë kaluan dhe pjesëmarrësit sidomos miqtë e çiftit që i dhanë harenë gjithë atij organizimi. Për-


VALBONA SELIMLLARI NË JUG ME VAJZËN



Valbona Selimllari gjithmonë e ka mbajtur larg familjen nga ekriani. Ajo ka postuar foto me djemtë, po këtë herë ne do e shohim duke pozuar me vajzën. Mesa duket ato po e shijojnë pafund këtë verë. Mami me të bijën janë duke i kaluar këto ditë të nxehta të verës në jug, ku duken mjaft të kënaqura në shoqërinë e njëra-tjetrës. Në foton e postuar në rrjetin social "Instagram" ato shihen të pandara teksa buzëqeshin fort. Valbona e bukur ngelet super në formë dhe pse është mami e tre femijëve.



ROZA LATI NGRE TEMPERATURAT



Ajo njihet si një nga personat më provokues dhe për postimet nga më provokueset. Roza Lati ka kohë që është bërë një nga emrat më të lakuar në show bizin shqiptar. Ajo sërish ka tërhequr vëmendjen me fotot e fundit që ka postuar në "Instastory". Lati është duke shijuar pushimet në një plazh të Ulqinit. Bukuroshja ka pozuar në majë të një shkëmbi, pa rripeta dhe gjoksit i ka vendosur emoji. Dalja e saj toples mesa duket i ka lënë pa fjalë të gjithë pushuesit.



ALESIA BAMI NUK DI TË NDALET, JA ÇFARË BËN MODELJA



Me një gjoks gjigand, të pasme bombastike, e fytyrë tepër të ëmbël, ajo është një prej femrave më seksi shqiptare. Alesia Bami, modele e balerinë, po e shijon një verë fantastike, dhe s'po ndalet së çmenduri ndjekësit me fotografi përvëluese nga pushimet. Po t'i shihni fotot e saj të fundit, do të bindeni që padyshim ajo është femra më seksi e kësaj vere. Kjo sezon pushimesh për bukuroshen ka qenë tejet i veçantë. Bami ka qenë mjaft provokuese dhe shumë në formë në postimet që ka ndarë me fansat në rrjetet sociale.



ANGELA MARTINI MË PROVOKUESE SE KURRË

angela_martini
Villa Treville Positano



Ka një bukuri të rrallë dhe shfaqet gjithmonë në formë. Modelja e famshme shqiptare Angela Martini është e bekuar me pamjen që ka dhe ajo, e ka shfrytëzuar maksimalisht bukurinë e saj duke u shndërruar në një modele dhe një grua të suksesshme në biznes. Martini që u martua gjatë vitit të kaluar në Las Vegas me të dashurin prej kohësh, Dragos Savulescu, nuk po i mbaron dot pushimet dhe po endet sa në një vend bregdetar në tjetrin. Në Positano të Italisë, modelja ka pozuar në rroba banje në një vend, i cili ka një pamje mahnitëse, por ne s'po vendosim dot, është më e bukur pamja prapa saj apo vet Angela Martini që ka ekspozuar linjat dhe këmbët e tonifikuara dhe duket më provokuese se



Shpesh pas larjes ose dushit mbetet pak ujë në veshë. Kjo përpos që nuk është ndjenjë e këndshme, mund të shkaktojë edhe infeksione. Me këto shtatë truke shpejt do t'i zgjidhni ato telashe. Nëse nuk mundeni dhe nëse ndieni dhimbje, patjetër shkoni te mjeku.

ME KËTA ARTIKUJ DO TË MUND TA HIQNI UJIN NGA VESHËT:

Përzieni disa pika alkooli dhe uthulle

Kjo përzjerje do ta lirojë kalimin e ujit nga veshët dhe do të pengojë infeksionin. Procedura është e thjeshtë. Në një shishe hidhni gjysmë alkool dhe gjysmë uthull, dhe me kulluese hidhni disa pika në vesh. Kullojeni duke e lëvizur kokën. Këtë nuk bën ta praktikoni nëse ju është lënduar membrana e timpanit.

BËNI VAKUM NË VESH

Shtypni me shuplakë veshin nga i cili nuk kullon uji. Shtypni derisa të bëni vakum të butë për nxjerrjen e ujit. Vakumin mund ta bëni edhe me gisht. Ktheni veshin poshtë, futni gishtin në të dhe shpejt nxirreni jashtë. Thani veshin me ajër të ngrohtë.

PËRDORNI THARËSEN E FLOKEVE

Rregullojeni në shkallën më të vogël dhe vendoseni 30 centimetra larg nga veshi. Ajri i ngrohtë

Si ta nxirrni më thjesht tepricën e ujit nga veshët



ndodhë që gravitacioni të bëjë të veten dhe uji të rrjedhë nëpër vrimë.

PËRTYPUNI OSE BËNI SIKUR JENI DUKE PËRTYPUR

Eshtrat e nofullës janë afër veshëve dhe lëvizjet sikur jemi duke përtypur ushqimin mund të ndihmojnë. Hani diçka, futni çamçakëzin në gojë ose thjesht improvizoni. Njëkohësisht lakoni kokën nga poshtë me veshin i cili nuk ka ujë, dhe vullshëm kthejeni në anën tjetër.

PROVONI TË GOGËSINI

Edhe gogësima ndihmon si edhe përtypa, sepse eshtrat përreth veshëve lëvizin. Kjo mund të sjellë lehtësim.



do të nxisë avullimin e ujit nga veshi. Kërceni në njëren këmbë. Lakojeni kokën në të njëjtën anë në të cilën veshi është plot ujë.

QËNDRONI NË NJËRËN KEMBË DHE KËRCENI

Njëkohësisht tërhiqni laprën e veshit, sepse kjo mund të zgjerojë pak kanalën e veshit. Nëse nuk dëshironi të kërceni, provoni të lakoni kokën dhe të tërhiqni laprën.

SHTRIJUNI DHE LLOGARISNI NË GRAVITACION

Shtrijuni në stomak dhe nga poshtë ktheni veshin i cili është plot me ujë. Qëndroni disa minuta. Mund të



Reuters: Ndryshimi i kufirit në Ballkanin Perëndimor, i rrezikshëm

Provokon Beogradi, mediat nxjerrin hartën e re me veriun e Kosovës

Thaçi: Në shtator vijon dialogu me Serbinë

Dialogu Kosovë-Serbi ende nuk ka përfunduar dhe ndërkaq tensionet mes këtyre dy vendeve sa vijjnë e po shtohen. Kjo është vënë re më tepër ditët e fundit nga pala serbe. Televizionet e Serbisë kanë filluar që në edicionin e lajmeve të shfaqin më të zgjeruar hartën e Serbisë këto ditë. Ajo që vihet re tashmë në ekrane është se Serbisë i është bashkuar Republika Serbe dhe Veriu i Kosovës. Ky duket të jetë hapi i parë i implementimit të idesë së liderëve serbë dhe presidentit Hashim Thaçi, për t'i lëvizur kufijtë. Pjesë e hartave që shfaqen në televizionet serbe është bërë tashmë edhe Republika Srpska e Bosnjës dhe Veriu i Kosovës, shkruan 'Gazeta Express'. Lajmet e mbrëmjes në televizionin "Prva" janë shoqëruar me hartën e një "Serbie të madhe". "Çfarë po shfaqet në lajmet e mbrëmjes në Serbi këto ditë: hartat që duken sikur Serbia ka aneksuar Republikën Srpska dhe Veriun e Kosovës", ka shkruar në Twitter, Jasmin Mujanović, eksperti i politikës për Evropën Juglindore. Ajo që po shfaqet në televizionet serbe, në kohën kur lëvizja e kufijve është kundërshtuar nga të gjithë fuqitë e mëdha, Mujanović e krahason me kohën e Millosheviçit. "Kjo është e një vijë me atë që ka bërë RTS gjatë kohës së Millosheviçit". Deklaratat e fundit të Presidentit, Aleksandar Vuçiq, për 'përcaktim kufijsh' në baza etnike, janë konkretizuar me hartat që televizionet po shfaqin. Mujanović thotë se presidenti serb dhe lideri i Republika Srpskas, Milorad Dodik, duan dhunë. Prekja e kufijve në Ballkan është cilësuar nga shtetet më të fuqishme të Bashkimit Evropian si tensionim i situatës dhe destabilizim. Nga ana tjetër, tema e mundësisë së ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, ka qenë në fokus



Media serbe me hartën e re të Kosovës

REUTERS

"Po të ndodhë ndryshimi i kufijve të Kosovës, atëherë kjo do të trimëronte serbët e Bosnjës që të ndanin Republikën serbe dhe t'ia bashkëngjisnin Serbisë. BE është fajtorë për hezitimin për debatin e kufijve në Ballkan", thekson Brunnbauer, citon Reuters.

të shumë mediave ndërkombëtare. Mes tyre gazeta austriake "Der Standard" dhe agjencia "Reuters" kanë publikuar artikuj ku pozicionohen kundër ndryshimit të kufijve. Agjencia e lajmeve Reuters në një shkrim të titulluar "Frenimi i BE-së promovon mosmarrëveshje të rrezikshme kufitare në Ballkanin Perëndimor" Andreas Rinke shkruan se "çdo ndryshim kufiri në rajonin e Ballkanit Perëndimor është i rrezikshëm". Reuters

citon drejtorin e Institutit për Evropën Juglindore në Universitetin e Regensburg, Ulf Brunnbauer, të ketë thënë se "po të ndodhë ndryshimi i kufijve të Kosovës, atëherë kjo do të trimëronte serbët e Bosnjës që të ndanin Republikën serbe dhe t'ia bashkëngjisnin Serbisë. BE është fajtorë për hezitimin për debatin e kufijve në Ballkan, thekson Brunnbauer, citon Reuters. Sipas tij, Franca dhe Holanda janë fajtorë që po kundërshtojnë

hapjen e bisedimeve të Shqipërisë dhe Maqedonisë me BE-në. Ky vakum i BE-së po shfrytëzohet pastaj nga vende si Rusia, Kina dhe Turqia, ka cituar Reuters ekspertin gjerman Ulf Brunnbauer. Ndërkaq, edhe gazeta austriake është marrë dje me këtë qësitë. "Normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe zbatimi i marrëveshjes midis Maqedonisë dhe Greqisë do t'ia hiqte Rusisë letrën kryesore nga dora". Kështu citohet të ketë thënë për gazetën austriake "Der Standard", drejtuesi i Qendrës për Evropën Juglindore në Universitetin e Gracit, Florian Biber. "Rusia po shfrytëzon dobësitë e të tjerëve në Ballkan", thotë Biber, teksa ka shtuar se ky ndikim mund të përmbys

STANDART

"Rusia po shfrytëzon dobësitë e të tjerëve në Ballkan", thotë Biber, teksa ka shtuar se ky ndikim mund të përmbys vetëm përmes një angazhimi të fuqishëm të BE-së dhe të një ambivalence të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", transmeton Der Standard.

SHKURT

Përmbytjet në Indi, 400 të vdekur e dhjetëra të zhdukur

Ka shkuar në 400 numri i të vdekurve nga përmbytjet në Indi këtë të hënë sipas autoriteteve vendase. Përmbytjet kanë përfshirë prej ditësh shtetin Indian të Keralas ku dhjetëra njerëz rezultojnë të zhdukur dhe 1.2 milionë janë strehuar në kampe. Kerala është përfshirë nga reshjet e shiut, të cilat kanë qenë 40 për qind më të mëdha sesa sezonet e kaluara. Për shkak të ujit të ndotur dhe kushteve të këqija higjienike autoritetet i frikësohen sëmundjeve dhe në këto zona janë dërguar ekspertët sanitarë. Dëmi nga përmbytjet deri tani vlerësohet në mbi tre miliardë dollarë, dhe pritet që kjo vlerë të rritet. Sfidë më e madhe për autoritetet indiane është pastrimi i zonave dhe i shtëpive për të mundësuar kthimin e banorëve në normalitet.

Zjarr në Paris, 5 fëmijë në gjendje kritike

Janë ende në luftë për jetën pesë fëmijë, pas shpërthimit të një zjarri në një papafingo në periferi të Parisit. Rreth 100 zjarrfikës u përballën me flakët rreth orës 19.00 të dielën në Aubervilliers, në veri-lindje të Parisit. Sipas 'Daily Mail', shtatë persona mbetën me lëndime serioze, mes tyre pesë fëmijë, jeta e të cilëve është në rrezik. Gjithashtu 10 oficerë policie dhe një zjarrfikës pësuan lëndime të lehta nga zjarri që shpërthoi në papafingo e një ndërtese dy-katëshe. Shkaku i flakëve mbetet i paqartë, megjithëse zjarrfikësit arritën ta mbanin situatën nën kontroll. Në të njëjtin qytet më pak se një muaj më parë, një zjarr në një kompleks strehimi shkaktoi vdekjen e një nëne dhe tre fëmijëve dhe la të plagosur nëntë persona të tjerë.

Lot e mallëngjim, banorët e dy Koreve takojnë familjarët e ndarë nga lufta

Pas 68 vitesh të ndarë, një grup nga Koreja e Jugut ka arritur në Korenë Veriore për të takuar familjarët që nuk i kanë parë nga koha e Luftës Koreane më 1950-1953. Kjo luftë ka ndarë Gadishullin Korean kështu që njerëzit që kanë jetuar në pjesën veriore e kanë pasur të pamundur lëvizjen. Të dy Koretë, që teknikisht janë ende në luftë, kanë organizuar bashkime familjare edhe më parë, mirëpo ky rast përbën ngjarjen e parë në tri vjetet e fundit. Personat që do të marrin pjesë do të kalojnë tri ditë në Korenë Veriore, mirëpo mund të qëndrojnë me familjarët e tyre vetëm disa orë në ditë apo 11 orë gjithsej. Shumica e takimeve të këtyre forcave të sigurisë. Ky organizim, i realizuar me ndihmën e Kryqit të Kuq,

Rekomandimi i inxhinierit: Kujdes nga amortizimi

Zbulohet raporti për urën "Morandi", ja paralajmërimi i rrezikut 40 vjet më parë



Ura e shembur e Morandit në Xhenova

struktura të ngjashme, të cilat ndodheshin në mjedis të ndryshme. Ai paralajmëroi: "Herët a vonë,

ndoshta pas disa vitesh, do të jetë e nevojshme të bëhet një rikonstruktim për të hequr të gjithë gjurmët e

PARASHIKIMI I INXHINIERIT TË URËS:

"Herët a vonë, ndoshta pas disa vitesh, do të jetë e nevojshme të bëhet një rikonstruktim për të hequr të gjithë gjurmët e ndryshkut dhe për të mbushur hendeqet. Duhet përdorim i një rrëshire artificiale për të mbuluar përfundim me materiale me një rezistencë shumë të lartë kimike", ka thënë inxhinier Morandi.

ndryshkut dhe për të mbushur hendeqet". Inxhinier rekomandoi përdorimin e një rrëshire artificiale për të mbuluar përfundim me materiale "me një rezistencë shumë të lartë kimike". Pjesët nga raporti u transmetuan në televizionin shtetëror RAI të dielën dhe u botuan në internet. Një pjesë e madhe e urës u shemb më 14 gusht, duke vrarë 43 persona, mes tyre edhe dy shqiptarë. Shkaku i ngjarjes është nën hetim dhe një ekip inxhinierësh të caktuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Transportit kryen një inspektim paraprak të dielën, pasi ekipet e shpëtimit përfunduan kërkimet e tyre për të zhdukurit. Roberto Ferrazza, kreu i ekipit qeveritar, tha se nga hetimi paraprak mund të sugjerohen një sërë shkaqesh të mundshme.

Pra katër dekadash, inxhinieri italian, i cili projektoi urën e Xhenovas që u shemb duke vrarë 43 persona, paralajmëroi rrezikun e amortizimit të urës. Ishte pikërisht Riccardo Morandi, inxhinieri që shkroi një raport në vitin 1979, duke rekomanduar mirëmbajtjen e vazhdueshme të strukturës, shkruan 'The Independent'. Raporti i lëshuar 12 vjet, pasi ura me emrin e tij u inaugurua, iu referua "humbjes së rezistencës kimike sipërfaqësore të betonit", për shkak të ajrit të detit dhe ndotjes nga një fabrikë çeliku aty pranë. Morandi, i cili vdiq në vitin 1989, këmbëngulte se projektimi i urës prej betoni ishte i saktë, por vuri në dukje rrezikun e amortizimit që nuk shihej në

Policia: Janë angazhuar mbi 100 efektivë për mbarëvajtjen e festës si dhe shmangien e aksidenteve

Berat, nis pelegrinazhi në malin e Tomorit

5 ditët e shenjtë të bektashinjve mbledhin 300-400 mijë pelegrinë

Eneida Petova

BERAT

Nis pelegrinazhi në Malin e Shenjtë të Tomorit. Festa e Shenjtë e Bektashinjve, e cila organizohet nga 20-25 gusht mbledh çdo vit në Teqenë e Kulmakut rreth 300-400 mijë pelegrinë nga e gjithë Shqipëria, diaspora e bota. Dje pelegrinët janë nisur drejt malit të Tomorit, një mal i konsideruar "i shenjtë", pasi në të prehet shenjtori i familjes së Profetit Muhamed, Abaz Aliu. Besimtarët kanë ngritur çadrat e tyre në këtë vend të shenjtë duke kryer jo vetëm kurbanin e festës, por duke ngjitur me këmbë edhe majën e Malit të Tomorit, i cili ndodhet 2416 metra mbi nivelin e detit. Të parët që janë vendosur në malin e shenjtë të bektashinjve kanë qenë barinjët e fshatrave të Skraparit, të cilët ofrojnë për pelegrinët kurbanët e festës, "qengjat" që janë dhe personifikimi i kësaj



Pelegrinët në malin e Tomorit



feste të veçantë.

Teqeja e Kulmakut është përgatitur dhe ka hapur dyert disa ditë më parë për të pritur pelegrinët që do të bëhen pjesë e kësaj feste si dhe janë të gjitha marrë masat që në malin e Tomorit të mos mungojnë çadrat për pelegrinët, banjat, ndricimi dhe uji i pijshëm. Gjatë 5-ditëve të pelegrinazhit, në Teqenë e Kulmakut dhe pranë varrit të Abaz Aliut kryhen ritet fetare të festës, ku çdo pelegrin falet për shëndet,

mirësi e paqe në familjet e tyre. Të gjithë besimtarët dhe pelegrinët që i bashkohen kësaj feste të shenjtë, në shenjë mirësie bëjnë kurban një qengj për veten dhe familjen.

PELEGRINËT

Vetë pelegrinët e parë që kanë mbërritur në malin e shenjtë u shprehën: "Për çdo vit bëjmë me qindra kilometra për të ardhur e për tu bërë pjesë e kësaj feste", thanë dje pelegrinët e parë që kanë mbërritur në malin e shenjtë.

Sipas tyre, pjesëmarrja në këtë festë të shenjtë është mjaft e rëndësishme, pasi u ka sjellë dhe vazhdon t'ju sjellë çdo vit vetëm mbarësi në familjet e tyre. Ndërkaq, sekretari i Kryegjiyshit të Bektashinjve për qarkun e Beratit, Zalo Qato u shpreh për "Gazeta Shqiptare" se këtë vit kushtet për mikpritjen e pelegrinëve janë përmirësuar dhe janë marrë të gjitha masat për akomodim. Krenar Capollari, shefi i sektorit të rendit në Komisa-

riatin e Policisë Skrapar, bëri me dije se për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti si dhe shmangien e aksidenteve në rrugën drejt Kulmakut janë nisur 100 forca policie që janë shpërndarë për të patrulluar në të gjithë aksion rrugor Çorovodë-Kulmak si dhe është hartuar një plan i detajuar masash që do të zbatohet me rigorozitet. Capollari konfirmoi se për 5-ditët e pelegrinazhit janë angazhuar të gjithë sektorët e Drejtorisë së Policisë së

RITET E FESTËS

Gjatë 5-ditëve të pelegrinazhit, në Teqenë e Kulmakut dhe pranë varrit të Abaz Aliut kryhen ritet fetare të festës, ku çdo pelegrin falet për shëndet, mirësi e paqe në familjet e tyre. Të gjithë besimtarët dhe pelegrinët që i bashkohen kësaj feste të shenjtë, në shenjë mirësie bëjnë kurban një qengj për veten dhe familjen.

Qarkut Berat, duke filluar që nga sektori i qarkullimit rrugor e deri tek sektori i rendit dhe ai i krimeve, ndërkohë që me ta kanë bashkëpunuar edhe bashkitë: Skrapar, Poliçan e Berat, të cilat kanë sjellë në Kulmak stafe mjekësore, ambulanca e zjarrfikëse.

Te gjitha te rejat nga jeta e vipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Opinion i Ditës

Mjekësi e lodhur, indiferente ose “mos u bëfsh për spital”

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

... e spitaleve të para nëntëdhjetës. Duhet ta provosh vetë këtë ndjesi për ta përdorur më pas shprehjen rutinë “Mos u bëfsh kurrë për spital”. Tashmë që arrita dhe unë në atë moshën e saj, e kuptoj drejt dhe qartazi shprehjen “Mos u bëfsh kurrë për spital”. “E kuptoj dhe si mallkim, por dhe si gortim për punonjësit e spitaleve, jo për të gjithë, e sidomos, jo për disa nga punonjësit e urgjencës... Para dy ditësh më takoi fati dhe mua të përfundoj në dyert e urgjencës së spitalit “Nënë Tereza” madje qysh në orën katër të mëngjesit... Kisha thjesht një bllokim urine, e shoqëruar me dhimbje dhe djegie të forta. Mora taksinë... Taksisti u tregua tepër i interesuar dhe i merakosur, duke më çuar me urgjencë gjer të hyrja e Urgjencës. Njerëzit e thjeshtë janë gjithmonë të përzemërt. E para gjë që më bëri përshtypje qysh në hyrje, ishte sportelista, një vajzë e veshur me uniformë policore, e cila nuk ma vari fare. As iu përgjigji pyetjes sime dhe as e ngriti kokën për të parë më kishte të bënte... Mbase, e lodhur nga hyrje-daljet e shumta, por ç'ne? Në atë orë njeriu shkon në spitalin e urgjencës vetëm nga një hall i madh.

U vërtita nëpër korridore me takoja ndonjë bluzëbardhë për të më ndihmuar, ose orientuar, por ç'ne? Ku e gjeje dot një njeri të tillë në atë orë. Në atë orë gjeje vetëm pastruesen që llamburiste pllakat kokulur dhe persona që dëgjiteshin nëpër korridore duke kërkuar një mjek...

Polices ndofta i ishte bërë shprehja të mos ngrinte kokën, por mjekëve a u ishte bërë shprehja vallë që të mos gjendeshin në atë orë pranë të sëmurëve?

Pyet andej, pyet këtej. Nuk shihja askënd me bluzë të bardhë. Vetëm të sëmurë, që vërtiteshin korridoreve duke kërkuar mjekun dhe të tjerë që dërgeshin krevateve. U tregua zemërmirë e në përshatje me detyrën që kishte një infermier i ri, me veshje jeshile, i cili më priti, më regjistroi emrin e më pas më drejtoi për të dhoma e Ekografisë... Mirëpo dhe atje mjeku nuk gjendej. Ku janë këta njerëz, mendova. Mos kanë ndonjë urgjencë ose ndonjë mbljedhje. Po ç'ne? Në kater të mëngjesit zakonisht nuk bëhen mbljedhje. Para dhomës së Ekografisë qëndruam së bashku me një plak tiranas, 85-vjeçar. Dhe ai kishte të njëjtin hall si unë... U tregua zemër gjerë pastruesja e cila, duke pastruar korridorin, e kish kuptuar shqetësimin tim, por vetëm ajo, ndaj ma bëri me shenjë që të shkoja e të



trokisja të një derë... por të mos thosha kush më dërgoi. “Trokit se atje e ke, më tha. Ashtu bëra. Pas disa trokitjeve dera u hap me përtesë. Ishte një vajzë e shkurtër, simpatike, e cila duhej të ishte mjekja e ekos... Nuk dua të vazhdoj më tepër me këtë mesele. Pas ekos u desh të prisja sërish gjer në orën pesë e tridhjetë që të behej i gjallë dikush nga mjekët e urgjencës. Ndërkohë që vëreja me kujdes gjendjen, persona të tjerë hynin duke mbajtur dikë për krahu.

Nga të gjashtë mjekët që duhet të ishin pranë të sëmurëve që rënkoin e kërkoin ndihmë, pas disa thirrjeve nga celulari u bë i gjallë vetëm një djale i ri, i cili me përzemërsi më vendosi kateterin. Kaq ishte dhe vuajtja ime. Asistimi në pavijonin e urgjencës, në orët e para të mëngjesit, ishte një rastësi, për të parë me sytë e mi se si funksionon shërbimi në urgjencat tona të natës.

Dhe ku! Në spitalin “Nënë Tereza”, ku të gjithë i kanë lidhur shpre-

sat, të moshuar dhe të varfër, tek ky spital publik, meqë shërbimi bëhet falas. Një mjek tjetër që desha ta takoja për të marrë ndonjë sqarim të mëtejshëm më ktheu shpinën. I tha infermierit të më sqaronte... Ajo ç'ka pashë në atë gjysmë errësirë mëngjesi, më vuri në mendime... Vërtet këta mjekë janë neglizhent ndaj detyrës së tyre, apo ajo që vura re unë ishte një rastësi... Vërtet kështu punohet në turnin e natës apo ishte vetëm ajo natë e tillë?

Mundet që puna e tyre rutinë, me të sëmurë që u sillen rrotull, nga mëngjesi në darkë, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, vit pas viti, i ka lodhur dhe i ka bërë më pak të gjallë vetëm dhe më pak të kujdesshëm ndaj qytetarëve apo ka diçka tjetër, e cila do përmirësuar?

Infermierit im tek i cili i varra të gjitha shpresat mori disa herë mjekët në celular. U përgjigj vetëm ai djali i ri, i cili erdhi pa vonesë... Duhet të ishin së paku gjashtë mjekë të turnit, tha ai... Ku

gjendeshin të tjerët? A mos vallë ishte bërë në heshtje një marrëveshje, për t'i marrë në celular; vetëm në qoftë se do të vinte një njeri i rëndësishëm në pavijonet e urgjencës, pasi njerëz të thjeshtë që hynin duke i mbajtur për krahu e duke duruar dhembjet e veshkave, apo të stomakut, i pashë vetë, me sytë e mi. Një grua e moshuar e shoqëruar nga një grua e re u shtrigati për tokë. E reja thirrte e mallkoi, por nuk u përgjigj askush.

Unë e kuptoj që mjekët janë mësuar me këta të sëmurë. Mbase i është bërë e zakonshme ardhja e personave me probleme shëndetësore, ashtu siç iu janë bërë të zakonshme dhe britmat e pacientëve dhe klithmat e atyre që i shoqërojnë... Unë i kuptoj mjekët e lodhur dhe indiferentë, dhe e di që nuk janë shumë të tillë, por dua t'u them se vetë ata, me dëshirën e tyre, e kanë zgjedhur këtë lloj profesioni humanitar... Në kontrast me këtë lloj shërbimi, unë mund t'u përmend plot raste të tjera të humanizmit, dhe në spita-

let tona, por shërbim për t'u admiruar do të gjeni dhe do të dëgjoni nga emigrantët tanë në spitale e huaja... Një shërbim që të prek dhe që të vë në pozitë të veshitirë, për ta falënderuar dhe shpërblyer mjekun me çfarë të mundësh.

Zotërinj doktorë, dhe doktoresha të nderuara, ju lutem, kini mirësinë që të na shërbeni siç e do puna dhe siç ua kërkon detyra... Unë një herë erdha pranë jush dhe mbeta i zhgënjyer... Të tjerë persona me probleme të mëdha shëndetësore i kini atje, çdo ditë.

Është ai, populli i thjeshtë, i varfër dhe i përvuajtur që kur vjen atje ju shikon ju në dritë të syrit si shpresa e tij e vetme dhe e fundit... Plaku 85 vjeçar, në ato pak çaste që qëndruam së bashku më tregoi se kishte gjashtë vjet që jetonte i vetëm. Gruaja i kishte vdekur. Fëmijët i kishte jashtë... Ishte tironi denabaden. Nuk ia mësova emrin. Po sa të tjerë përplasen në mesnatë të porta e urgjencës së spitalit “Nënë Tereza”? Nga Tirana dhe nga rrethet... Për ata ju jeni shpresa e vetme. U shikojnë ju, në sy, sikur të shikojnë Zotin. Pra, ju lutem, keni bërë betimin e Hipokratit kur jeni futur në ato banka shkollë të cilat ju kanë ngritur gjer në këtë detyrë humane dhe njerëzore. Kryejeni punën me dashamirësi dhe mirëkuptim, se, të them të drejtën, të vetmit persona me ndjenjë humane në atë pavijon, ish-infermierit dhe pastruesja. Ata po. Ata ishin në krye të detyrës dhe nuk u ishin tharë akoma ndjenjat njerëzore. Në rininë time, si shumë të tjerë, dhe unë kam ëndërruar të bëhesha mjek. Mjek nuk u bëra, por mjekësinë e kam dashur dhe e dua shumë. Tani mendoj se, po të isha bërë një mjek, puna ime me të sëmurët do të ishte vërtet e lodhshme, por dhe me satisfaksion. Problemi qëndron tek paga. Është paga e mjekut ajo që nuk e justifikon as lodhjen as satisfaksionin. Është një pagë e ulët për një punë sfilitëse, ajo që i bën disa prej mjekëve tanë, jo të gjithë, të kuptohemi, të sillen ndaj profesionit të tyre si ndaj një profesioni të çfarëdolloshëm. Nuk është vetëm pasioni. Është dhe paga. Në qoftë se paga e një mjeku do t'i kalonte 1000 eurot, e mjaftueshme për kushtet tona, dhe impenjimi, interesi dhe përkushtimi ndaj detyrës do të ishte më i madh.

Duke qenë dëshmitar i një bjerreje të interesi të punës së mjekut, në një nga spitalet tona më të mira, mendoj dhe do t'i sugjeroja shtetit që t'i ngrinte urgjentisht pagat e punonjësve të mjekësisë. Vetëm kështu dhe vetëm ky lloj stimulimi material do ta kthejë mjekësinë në destinacionin e vet humanitar.

Opinion *i* Ditës

Terrorizmi dhe propaganda, pjesë e një strategjie

Nga Wes Martin

(vijon nga faja 1)

... në vend të portave të Kampeve Ashraf dhe Liberty në Irak, Mostafa është në Shqipëri, në vendin ku ndodhet kampi i ri i refugjatëve të Mujahedin e-Klahe (MeK).

Gënjeshtra e Mostafa-it është thjesht një faqe nga libri i vetëm i strategjive që kanë krijuar ekstremistët iranianë që sundojnë Teheranin, në përpjekjet e tyre për të shkatërruar jetët dhe besuesmërinë e refugjatëve të MeK, të cilët janë vendosur tashmë në mënyrë paqësore në një komunitet jashtë Tiranës.

Mostafa pretendon se e bija, Somayah, është rrëmbyer nga MeK dhe është mbajtur për vite të tëra kundër vullnetit të saj. Si të gjithë refugjatët e MeK, Somayah është intervistuar nga Byroja Federale e Investigimit e Shteteve të Bashkuara (FBI) në vitin 2004.

Gjysmë dekadë më vonë, për të përcaktuar nëse pretendimi i babait të saj kishte ndonjë validitet, Somayah u intervistua sërish nga Komandanti i Ushtrisë Amerikane të Kampit Ashraf, Nënkoloneli (LTC) Leo McCloskey. Somayah ia bëri të qartë LTC McCloskey-it se ajo qëndronte në Kampin Ashraf me vullnetin e saj të lirë. Somayah nuk kishte asnjë dëshirë të largohej dhe e zhvlerësoi pretendimin të atit.

Në kohën ndërmjet intervistave të FBI dhe LTC McCloskey, unë kam shërbyer si Komandant i Bazës së Ashrafit. I vizitoja vazhdimisht të gjitha komplekset e banorëve të MeK. Po të kishte dashur Somayah të largohej, ajo mund të kishte kërkuar ndihmë. Kushdo ta kishte bërë këtë, unë do ta kisha përcjellë personalisht jashtë kampit.

Për më tepër, unë përpilova së bashku me lidhshinën e MeK një protokoll të shkruar për banorët që donin të transferoheshin në kampin e operuar nga amerikanët. Ky protokoll u krijua pjesërisht për arsye se udhëheqja e MeK më solli në vëmendje banorë që e ndienin se shërbimi i tyre ndaj MeK kishte përfunduar dhe tani donin ta lirin organizatën. Ne strehuam pothuajse dyqind prej tyre dhe duhej të krijonim procedura zyrtare për transferim. Somayah mund të ishte transferuar edhe përmes këtij procesi po të kishte dashur.

Për sa i përket librit të strategjive që përmenda më sipër, ajo çfarë më shqetëson më shumë janë kapitujt e tjerë për të cilët kam qenë dëshmitar gjatë kohës që shërbeja si Officer i Lartë i Anti-terrorizmit për të gjitha Forcat e Koalicionit në Irak, Shef i Operacioneve të Operacioneve të Ndal-



imit (Task Force 134), dhe si Komandant i Ashrafit. Kapitujt e tjerë të librit përfshijnë sabotimin e stabilitetit të kundërshtarëve të tyre apo atyre që i perceptojnë si kundërshtarë. Kjo përfshin edhe më shumë operacione të hapura shpjiqje në përpjekje për të krijuar një mjedis armiqësor për banorët. Ashtu siç u bë me sukses në Irak, Irani po luan ndaj qeverisë shqiptare me oferta diplomacie, ndihmese dhe mbështetjeje. Sulmet tokësore dhe me raketa janë, gjithashtu, të përfshira në këtë libër strategjish, i cili përfundon me një përpjekje për ta detyruar qeverinë mikpritëse që t'i përjashtojë banorët nga vendi.

Sulmi im i preferuar shpifës nga MOIS ka qenë kundër meje. Gjatë viteve, jam akuzuar në mënyrë të rreme nga një ish-anëtar i MeK, i cili banonte në kampin e kontrolluar nga amerikanët, dhe që u rek-

rutua më vonë nga MOIS. Akuzat ishin që unë kisha abuzuar me banorët të tjerë të transferuar në vitin 2005. Në atë vit unë kam qenë i pozicionuar në Pentagon, dhe nuk kam qenë në Ashraf deri në vitin 2006. As dy oficerët e tjerë amerikanë të akuzuar se më kishin shoqëruar mua në këtë abuzim nuk kishin qenë në kamp në kohën që pretendonte akuzat. Njëri kishte ikur më përpara, ndërsa tjetri do të vinte disa vite më vonë. Ne të tre nuk u takuam asnjëherë deri në vitin 2011. Me një fjalë, këto akuzat janë krejtësisht të pabazuara.

Irani, shteti numër një për sa i përket eksportit të terrorizmit, është, gjithashtu, numri një për eksportin e propagandës. Një përgjegjësi madhore e MOIS është të parandalojë apo të minimizojë zbulimin e provave që lidhen me qeverinë e saj të korruptuar e sh-

tipëse. MOIS e lufton të vërtetën me gënjeshtra, mashtrime, dhe manipulim faktesh. Nëse kërcënim i perceptuar nuk mund të neutralizohet as me këto mënyra, atëherë MOIS i kthehet mjeteve vdekjeprurëse, si atentati i fundit i dështuar për të bombarduar tubimin paqësor të rezistencës në Francë.

Për sa i takon Mostafa Mohammad-i, ai është vetëm një faqe e hershme në librin e strategjive të MOIS. Nuk ka asnjë të vërtetë në ato çfarë ai pretendon. Ai po bën atë që ka bërë edhe në Irak, duke përhapur gënjeshtra e duke torturuar një grua të re, dëshira kryesore e së cilës është t'i shohë të gjithë qytetarët iranianë të çliruar nga tirania që sundon vendin e tyre.

*** Kolonel në pension, ish-komandant i kampit Ashraf**

HOROSKOPI

DASHI
Pse duhet të punoni kaq shumë, nëse nuk i shijoni frytet e kësaj pune? Mundohuni ta bindni veten tuaj se jeta duhet jetuar dhe shijuar në çdo moment.

DEMI
Dita e sotme mund të jetë e qetë për ju. Do të kaloni një kohë të bukur pranë personave të dashur. Një ndryshim në jetën tuaj do ju bënte mirë. Situata pozitive në qeshjet e parave.

BINJAKET
Ndoshta në këtë moment po e teproni me seriozitetin tuaj. Eshhtë e nevojshme që të buzëqeshni më shumë. Në fund të ditës do të përfundoni duke qeshur me zemër.

GAFORJA
Nuk bëni keq që t'i ktheheni fëmijërisë suaj dhe të kujtoni momentet e bukura të saj. Kjo do ju nxisë që t'i telefononi disa miqve të së shkuarës për të përjetuar sërish ato çaste.

LUANI
Lërimi pas konkluzionet që keni nxjerrë në punë dhe përqendrohuni tek vetja tuaj. Merrni në konsideratë propozimet që ju bëjnë njerëzit, ndoshta do jenë produktive.

VIRGJERESHA
Eërë të reja do të nisin të fryjnë duke larguar retë e zeza të cilat ju kanë mbuluar kohët e fundit. Çfarë mund të kërkonti me shumë? Do të merrni frymë më lirish.

PESHORJA
Sot për ju mund të jetë një ditë e shndritshme. Çfarë lehtësimi do të jetë pasi të lini pas tensionin e këtyre ditëve. Do të jetë dita e duhur për të diskutuar ngrohtësisht me një mik të vjetër.

AKREPI
Nëse ju ka lindur dëshira për të nisur një kurs profesional apo një shkollë, mos hezitoni ta bëni këtë. Asnjëherë nuk është keq që të mësoni gjëra të reja në jetë. Edhe në dashuri jeni të favorizuar.

SHIGJETARI
Diçka është duke lulëzuar brenda jush. Presioni i së kaluarës do të fashitet dhe ju do të ndiheni në formë të shkëlqyer dhe optimiste. Bëni më shumë stërvitje dhe nisni zakone të shëndetshme.

BRICJAPI
Duket se shumë njerëz ju kanë mbyllur derën në fytyrë, por çfarë lehtësimi do të jetë kur kjo gjë të mos ndodhë më. Yjet ju favorizojnë dhe shumë probleme mund të zgjidhen.

UJORI
Do të shijoni xhentilesën dhe mirësjelljen e një personi në jetën tuaj. Do të jeni me bashkëbiseduesesë sesa zakonisht. Keni intuitë të fortë ndaj dëgjimit dhe vëmendjeje.

PESHQIT
Ditë e kaluara kanë qenë pak të rrëmujshme për ju dhe sot do të habiteni me kthjelltësinë që do t'ju karakterizojë. Përfitoni nga kjo situatë pozitive pa u menduar gjatë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET




INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotualet.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.

36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishtë nija që preu Alekdansri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishtë babai i Aklit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Writen nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një çigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë nginjia.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.


35. Mbyllin një ditar.
36. Sateliti i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Iniciallet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kujfi.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gysma e lujjes.
19. Castellito aktor.
20. Iniciallet e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Iniciallet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 8 | 1 | 2 | | 4 | | | |
| | | | | | 5 | | | |
| | | | 3 | 6 | | | 7 | |
| 1 | | 9 | 4 | 7 | 6 | | | |
| | | | 5 | | 8 | | | |
| | 6 | | | | | 2 | | |
| 7 | | 2 | 1 | | | | | |
| 5 | 8 | | 6 | | | | | 3 |
| | | | 3 | | 9 | | | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 6 | 9 | 8 | 7 | 2 | 4 | 5 | 3 |
| 2 | 7 | 4 | 3 | 1 | 5 | 6 | 8 | 9 |
| 3 | 8 | 5 | 4 | 6 | 9 | 1 | 7 | 2 |
| 4 | 1 | 7 | 9 | 3 | 8 | 2 | 6 | 5 |
| 8 | 9 | 6 | 5 | 2 | 7 | 3 | 1 | 4 |
| 5 | 3 | 2 | 1 | 4 | 6 | 7 | 9 | 8 |
| 9 | 2 | 1 | 6 | 8 | 4 | 5 | 3 | 7 |
| 6 | 4 | 8 | 7 | 5 | 3 | 9 | 2 | 1 |
| 7 | 5 | 3 | 2 | 9 | 1 | 8 | 4 | 6 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Zemra e njeriut ka kufi në dashuri, por jo edhe në urrejtje.
- Në vetmi i vetmuari shqyen veten e vet, në shoqëri e shqeyen të tjerët.
- Aftësia për të falur është një privilegj i të fortit. Të dobët kurrë nuk falin.
- Nëse gjithmonë bën atë që të pëlqen, të paktën një person është i kënaqur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | |
|----|---|----|---|----|----|----|---|----|----|----|----|---|
| 3 | 1 | 7 | 2 | | 7 | 3 | | 13 | | 2 | | |
| 2 | 7 | 5 | | | 8 | 4 | 3 | 5 | 7 | 2 | 6 | |
| 7 | | 3 | 1 | 9 | 1 | 6 | 5 | 10 | 6 | 2 | 6 | |
| | | 3 | 5 | 8 | 2 | 3 | 5 | 6 | 1 | 7 | 5 | |
| 12 | 5 | 13 | 5 | 10 | 1 | 7 | | 6 | | 13 | | |
| 2 | 7 | 18 | | 5 | 11 | 2 | 6 | 5 | 8 | 2 | 6 | |
| 8 | 2 | 6 | 2 | | 2 | 1 | 8 | 5 | 11 | 1 | | |
| 1 | 6 | 8 | | 17 | 9 | 5 | 7 | 2 | | 9 | | |
| 3 | 1 | 5 | | 8 | 2 | 16 | | | 2 | 7 | 1 | |
| 2 | | | | 3 | 2 | 6 | 5 | 9 | 2 | | 13 | |
| 6 | 2 | 7 | 2 | | | 3 | | 7 | 18 | 3 | 6 | 7 |
| | | 3 | 4 | 8 | 5 | 19 | 1 | 5 | | 3 | 5 | 2 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B | A | S | T | E | T | P | A | P | A | | |
| U | R | A | T | U | R | H | P | A | | | |
| S | A | M | M | M | A | R | A | I | N | I | |
| T | A | M | E | R | I | K | A | N | E | T | |
| P | R | O | T | E | S | T | A | N | T | E | T |
| G | J | I | G | A | N | T | I | I | R | R | |
| B | E | T | O | N | E | K | B | O | A | T | |
| S | A | L | I | R | A | M | A | E | | | |
| G | O | N | T | I | T | U | L | L | A | R | |
| A | R | E | S | A | O | | | | | | |
| Z | J | A | R | Z | O | T | I | M | E | T | |
| I | A | M | E | R | E | N | G | U | E | S | |

PËRGJIGJETE E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL
 1. MUND TË JETË KURSIMI
 5. YLLI I NOSTRADAMUS
 8. TAMAM PA KUFIJ
 11. ROSS KËNGËTARE
 13. I LASHË
 15. ESHËTË ALEANCA KU SAPOI KEMI ADERUAR
 19. KUFIJTË E LËVIZJES
 20. I KA TEK PLEPI
 21. PAGUHEN PËR SHËRBI
 23. FILLOJNË LEJEN
 24. KUFIZOJNË TROTUALET
 25. BËJNË KARRIERË NË PARTI
 27. THAHET ME BONIFIKIM
 28. MUND TË JETË UNIK NJË I TILLË
 29. PREKA KOMIK SHKORDRAN
 31. FUND DHJETORI
 32. FILLOJNË AKSIONIN
 33. ENTE OPERATIVE TIRANË
 34. AGJENCI AJRORE DURRËS

VERTIKAL
 1. SI I PËRSHTATËSHËM
 2. MUND TË JENË FETARE
 3. AI I KUQ E KA NJË HUQ
 4. PAK ANALOGJI
 6. ESHËTË METRI I RROBAQEPËSIT
 7. NË HYRJE TË OAZIT
 8. ARTE PA RE
 9. ARTHUR QË QE DRAMATURG
 10. JANË BOSHTË
 12. MICHELANGELO REGJISOR
 14. MUND TË BËJË STIL TË LIRË
 16. ISHIN MONEDHE TE TOBIAS
 17. ESHËTË BAS ME KATËR TELA
 18. PAK EFIKASITET
 22. ESHËTË MARRËVESHJE ME NOTA
 25. ISHËTË BABAI I AKLIT
 26. FILLOJNË NAZET
 27. NË KRYE TË KUADROVE
 29. ESHËTË FAQE MURI
 30. NJË APENDISIT I MENJËHERSHËM
 35. KUROSAWA QË QE REGJISOR
 36. WRITEN NGA ESPADA
 37. ESHËTË SHTET AZIATIK
 38. EDOUARD PIKTOR
 40. NJË TRANSPORTI ËSHËTË KAMIONI
 45. UNI I FREUD
 46. NJË ÇIGAN
 47. FUNDI I NJË SAMURAI

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL
 1. FILLOJNË PANIKUN
 3. GIBSON AKTOR
 5. NË MES TË COGITO DHE SUM E THËN NGA DESCARTES
 9. MUND TË JETË TROFE
 11. JANË VENDET SI KATARI
 14. MAUREEN QË QE AKTORE
 16. JANË KUNDËRMUESE
 17. MUND TË FITOJNË ETAPA
 20. USHTOJNË NGA "OLA"
 22. NJË THIRRJE
 26. JANË MINISTRITË
 27. NJË RRUGË NË PARIS
 28. MARKË CIGAREJE
 29. ESHËTË NGINJIA
 32. RICCIARELLI SOPRANO
 33. FILLOJNË SEFTE
 34. ENTE EKONOMIKE SARANDË

VERTIKAL
 1. NJË VOTË NË FAVOR
 2. FILOZOFI ME EKSPERIMENTIN E GOMARIT
 3. NË HYRJE MAKINËS
 4. FILLOJNË LEHTË
 5. IRLANDA NË DUBLIN
 6. ESHËTË EDHE AJO E HISTORISË
 7. NJË PJESE E GAMILJEVE
 8. NOTAT PA KUFIJ
 9. ISHIN KOMITË
 10. KA KRYEQYTET ISLAMABAD
 12. DON... I INTERPRETUAR NGA TERENCE
 13. MBYLLIN AKTET
 15. JANË PËRMASA
 18. GYSMA E LUJJES
 19. CASTELLITO AKTOR
 20. INICIALLET E DALÍ, PIKTOR
 21. TANITA KËNGËTARE
 23. ESHËTË TRYZNI
 24. NË HYRJE TË EUROPËS
 25. JANË RROBAT PËR T'U LARË
 30. BËN MËZA
 31. MOREAU AKTORE
 32. JANË THIKA
 39. NJË PJESE E SATELITIT
 40. JANË TEKE NË SENDE
 41. PAK MARRAMENDËSE
 42. I KA TEK ZDAPI
 45. INICIALLET E NOLTE-S

Thënie të mënçura

- Të jesh i zemëruar, do të thotë të hakmerrsh ndaj vetes tënde për gabimet e të tjerëve.
- Nuk ka kashë më të egër se njeriu kur zotëron forcë të barabartë me pasionet e tij.
- Me një armë të zbrazët mund ta trembësh armikun, por nuk mund ta zhdukësh.
- Rregullat e fesë në agjërimë dhe festa respektohen mjaft mirë. Të pasurit respektojnë festat dhe të varfërit agjërimet.

